Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Ilir Halili	**21.09.2023**	**16.10.2023**	**2023/0715**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 21.09.2023, OE "RUNWAY SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0715, kundër njoftimit për kontratë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "RUNWAY SH.P.K."- Prishtinë, apo kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me uniforma per detyra taktike" me nr. të prokurimit: "214-23-2841-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS.Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedur? t? hapur, negocuar, kufizuar, lloji i kontrat?s: pun?, furnizim, sh?rbim, vlera e parashikuar e kontrat?s: xx,xxx €.Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0715 i dt:21.09.2023.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Shkeljet e LPP-se nga ana e AK-së:

Faqe 3 nga 42

Neni 1 Qëllimi,

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi,

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve.

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës,

Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit.

Gjithashtu AK ka shkelur edhe dispozitat përkatëse te RrOPP-se 82/2022 .

Gjithashtu AK ka shkelur edhe dispozitat përkatëse te Udhëzuesit 01/2023

Te pakenaqur me vendimin e Autoritetit Kontraktues POLICIA E KOSOVËS te dates 12.09.2023 ne

lidhje me aktivitetin e prokurimit: Furnizim me uniforma për detyra taktike me nr. te prokurimit: 214-23-

2841-1-1-1 dhe Nr. i brendshëm: 214/23/022/111 ne afatin ligjor konform nenit 109 te LPP-së, ushtrojme

kete ankese prane OSHP-se:

Për shkak se AK- POLICIA E KOSOVËS :

- ne mënyre te kundërligjshme e ka anuluar këtë aktivitet te prokurimit pasi qe ne mënyrë te

kundërligjshme na ka eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit edhe pse i kemi plotësuar te

gjitha kërkesat e AK-se te vendosura ne NJK dhe DT.

- AK na ka diskriminuar haptas ne këtë tender ne krahasim me OE-ne tjetër i cili ka aplikuar ne

ketë tender.

Sqarojmë ne mënyrë të detajuar:

Faqe 4 nga 42

Autoriteti Kontraktues POLICIA E KOSOVËS me datën 29.08.2023 ka Publikuar njoftimin B58 ku

e ka anuluar këtë aktivitet te prokurimit, ne kundërshtim me nenin 62 te LPP-se.

Te pa kënaqur me kete vendim te AK-se per anulim, me date 04.09.2023 kemi parashtruar kerkese

per rishqyrtim pranë AK-se dhe me datën 12.09.2023 AK na kthen përgjigje ku kunderligjeshem na

refuzon kërkesën tone per rishqyrtim.

Sqarojmë OSHP-në se neve kemi Ofertuar ne këtë tender me çmim 2,025,540.00€ ndërsa Operatori

tjetër Ekonomik OE "Sodex Group" ShPK ka ofertuar me çmim prej 2,799,746.40€ gati 800,000.00€

me shtirjet sesa neve ku neve kemi ofertuar me tender te përgjegjshëm dhe me çmimin me te lire

ashtu siç ka qene kriter për dhënie te kontratës te përcaktuar nga AK ne NJK dhe DT.

Me poshtë po e paraqesim letrën standarde për eliminim te cilën AK na ka dërguar.

Faqe 5 nga 42

Faqe 6 nga 42

Po i sqarojmë pikat e eliminimit ku sipas AK-se nuk i plotësojmë te gjitha specifikat teknike te detyrueshme

dhe se mungojnë disa standarde te testimit te kërkuara ne specifikat teknike ku një nga një po i sqarojmë si me

poshtë:

Sipas AK-se:

1.

Si pike e pare e eliminimit sipas AK-së është se : te artikulli nr.1 Xhaketë Taktike, Xhaketa e jashtme është

kërkuar 10k/10k e pa përshkueshëm nga era dhe uji – mungon ne 10k/10k ne testime;

sqarojmë se Artikulli nr. 1 Xhaketë Taktike ku thuhet se Xhaketa e jashtme është kërkuar 10k/10k e pa

përshkueshëm nga era dhe uji – mungon ne 10k/10k ne testime, nuk qëndrojnë këto konstatime pasi qe neve

e kemi ofruar raportin e atestit Nr. 33200 /10.05.2023 i UNIVERSITY OF CHEMICAL TECHNOLOGY AND

METALLURGY – SOFIA ku përgjigjen na jep tek shembulli 1, testi numër 3. ku shume qarte shihet se janë kryer

atestet për Xhaketën Taktike dhe i përmbush te gjitha specifikat teknike te kërkuara sipas AK-se ne DT me metodat e

testimit te laboratorit ndërkombëtar ku këto ateste dëshmojnë qarte se artikulli i plotëson te gjitha standardet

ndërkombëtare sipas metodave te testeve BSS, EN dhe ISO.

AK ne pergjigjen mbi kërkesën per rishqyrtim lidhur me pretendimin e parë dhe ne refuzimin e kërkesës tone

na jep kete përgjigje si me poshtë:

Faqe 7 nga 42

Sqarojme ekspertin shqyrtues dhe panelin shqyrtues se sipas AK-se eshte kerku Xhaketa e jashtme

është e qepur dhe e ngjitur me tegel plotësisht të vullkanizuar për rezistence ndaj uji, ndersa OE e ka

ofruar xhaketen jashme eshtë ber me shirit te pa vullkanizur, kete pretendim AK e ka shtuar dhe nuk

ak qene per eliminum ne vendimin e Ak-se dhe ne letrën standarde per eliminim, Pra shihet qarte se AK po i shtrembëron gjerat pasi qe Ky predentim i AK-së nuk qendron dhe eshte per tu quditur se si ky komsion hyjne ne punen e lebratorit nderkomtar, ku shume qarte lebratori i univerzitetit sofjes e ka bere testimin e vullkanizimit, rezistencen ndaj ujit ndersa zyrtaret e AK-se me hamendje i testojn vullkanizimet dhe ristencen ndaj ujit, Këtu nuk kemi koment nga ana jone pra sytë e tyre janë me profesional se vet laboratori.

Ndërsa sa i përket pretendimin ankimor për artikullin nr 1 Xhaketë Taktike Xhaketa e jashtme eshtë kërkuar • 10k/10k e papershkueshem nga era e uji - mungon ne 10k/10k ne testime - sa i për këte ketij pretendimit

Atëherë kemi nga rezultatet e testeve se eshte e nënvizuar me ngjyre te kuqe te nr rendor 3. Resistance to water penetration.

Sipas AK-se Pikërisht duke u bazar ne kete testim shihet shume qarte qe nuk është 10k(10,000) mirëpo eshté Ofruar 1.3k(1300 +- 10) qè dotè thot se nuk e plotëson kerkesën e kërkuar ne specifikacionet teknike prej 10k/10k. Pretendimi ankimor eshte i pa bazuar.

Sqarojme ekspertin shqyrtues te OSHP-se dhe panelin Shqytues se, si pike e pare e eliminimit sipas AK-së është se : te artikulli nr.1 Xhaketë Taktike, Xhaketa e jashtme është kërkuar 10k/10k e pa përshkueshëm nga era dhe uji – mungon ne 10k/10k ne testime;

sqarojmë se Artikulli nr. 1 Xhaketë Taktike ku thuhet se Xhaketa e jashtme është kërkuar 10k/10k e pa përshkueshëm nga era dhe uji – mungon ne 10k/10k ne testime, nuk qëndrojnë këto konstatime pasi qe neve e kemi ofruar raportet e atesteve Nr. 33200 /10.05.2023 i UNIVERSITY OF CHEMICAL TECHNOLOGY AND METALLURGY – SOFIA Pra zyrtaret e AK-se nuk e kuptojnë se si duhet te lexohen atestet dhe me vertet esht per tu ardhur keq nga nje vlersim i tillë i zyrtareve te AK-se, ku

Faqe 8 nga 42

shum lehte mund te hyhet ne internet apo mund te pysin lebratorin se cka eshte 10K/10k e jo me hamendje te hin ne punen lebratorit qe nuk i kuptojn kto testime.

mostra jone shihet shume qart se esht me cilsi shumë me te mir gjithnje duke u bazur ne testimet e Lebratorit, sqarojm se mostra e jone e tejkalon kërkesën e AK-se prej 10k /10k ku shume qarte shiehet nga raporti i atestit.

Pra shume qarte Laboratori e ka thene se këto mostra e përballojnë presionin prej më shumë se

1300k+10 Rezistenca ndaj depërtimit të ujit pra eshte me e qëndrueshme sesa kërkesa e AK-se.

2.

pike tjetër e eliminimit sipas AK-së se : është kërkuar pjesa e belit duhet te jete elastike – sipas mostrës nuk

është elastike. Neve e kemi dorëzuar Xhaketën komplet sipas spicifikave teknike, Xhaketa jone e posedon

pjesen e belit elastike dhe nuk qendron konstatimi i AK-se, i komisinit te vleresimit pasi qe qarte shihet pjesa

elastike ne xhaketë, si ne foto me poshtë:.

Faqe 9 nga 42

AK ne pergjigjen mbi kërkesën per rishqyrtim dhe ne refuzimin e kërkesës tone na jep kete përgjigje lidhur me

pretendimin e dytë, si me poshtë:

Faqe 10 nga 42

Sqarojmë ekspertin shqyrtues dhe panelin shqyrtues se neve e kemi dorëzuar Xhaketën komplet sipas

spicifikave teknike, Xhaketa jone e posedon pjesen e belit elastike dhe nuk qendron konstatimi i AK-se, pasi

qe qarte shihet pjesa elastike ne xhaketë. Pra Ak manipulon me kërkesa dhe foto pasi qe kjo foto sipas AK-se

eshte per fund te xhakese e jo per bel te xhaketës.

3.

pike tjetër e eliminimit sipas AK-së se : është kërkuar te Aneksi 1 Standardet testi i analizës se fibrave për

xhaketën e brendshme – mungon ku testim (STANDARDET E LARTEPERMENDURA DUHET TE

DOKUMENTOHEN ME RAPORTE TESTUESE NGA LABORATORET ME AKREDITIM

NDERKOMBETAR).

Kemi dorëzuar Ateston me numër Nr. 33200 /10.05.2023 i UNIVERSITY OF CHEMICAL TECHNOLOGY

AND METALLURGY – SOFIA ku shume qarte përgjigjen na jep tek shembulli numër 3, testi numër 1 –

quantitative composition.

AK ne pergjigjen mbi kërkesën per rishqyrtim dhe ne refuzimin e kërkesës tone na jep kete përgjigje lidhur me

pretendimin e tretë, si me poshtë:

Sqarojmë ekspertin shqyrtues dhe panelin shqyrtues se si zyrtaret e AK-se nuk kane dijeni lidhur me

këto çështje pasi qe shihet se fjalët e përdorura ne ateste i kane marrre nga google translate qe don te

thotë se as qe kane lexuar raporte te atesteve ne realitet por arsyet e tyre vetëm i kane gjet si pretekste

per te na eliminuar.

Faqe 11 nga 42

Shume qarte logjikisht po bajme pyetje se a me mire jep rezultate nje laborator ndërkombëtar qe i ka

testuar mostrat apo zytrtaret e AK-se qe i shohin mostrat me sy dhe hyjn ne google dhe japin

konstatime sipas hamnedjes se tyre. Eshte shume leht qe te sqarohen këto çështje nëse pyetet

laboratori.

4.

pike tjetër e eliminimit sipas AK-së se : Artikulli nr.3 Pantallona Taktik dimëror është kërkuar " Pjesa e belit

e vete përshtatshme (elastike) – sipas mostrës pjesa e belit nuk është elastike;

Neve kemi dorëzuar pantallonat Taktik dimëror me pjese elastike te belit dhe nuk qendron konstatimi i AKse, i komisinit te vleresimit pasi qe qarte shihet pjesa elastike ne belin e pantallonave, si ne foto me poshtë:.

AK ne pergjigjen mbi kërkesën per rishqyrtim dhe ne refuzimin e kërkesës tone na jep kete përgjigje lidhur me

pretendimin e katertë, si me poshtë:

Faqe 12 nga 42

Sqarojmë ekspertin shqyrtues dhe panelin shqyrtues se si zyrtaret e AK-se edhe pse shihet me sy ata

per mostrat tona i mbyllin sytë pra mostrat janë aty dhe mund ti sheh eksperti shqyrtues dhe paneli

shqyrtues se pantallonat ne pjesën e belit janë elastike komplet sipas kërkesës se AK-se te vendosur

ne DT.

5.

pike tjetër e eliminimit sipas AK-së se : Artikulli nr. 4 KËMISHË TAKTIKE - ME MANGE TE GJATA

VERORE – është kërkuar te Aneksi 1 * spaletat për bartje te gradave ne kraharor, mungon vendi për

vendosjen e spaletave per bartjen e gradave ne Kraharor.

Neve kemi dorëzuar KEMISHA ME MENGE TE GJATA VERORE ashtu siç është kërkuar te Aneksi 1 •

Spaletat për bartje te gradave ne kraharor, dhe arsyeja e eliminimit nuk qëndron pasi mostra jonë i plotson

specifikat, mostra jonë i posedon velegron për, Spaletat për bartje te gradave ne kraharor, sepse ne specifik ka

qen: Mënyra e vendosjes se emblemave dhe spaletave mund te ndryshoj varësisht nga kërkesa shih fotot si me

poshtë:

Faqe 13 nga 42

Faqe 14 nga 42

Faqe 15 nga 42

AK ne pergjigjen mbi kërkesën per rishqyrtim dhe ne refuzimin e kërkesës tone na jep kete përgjigje lidhur me

pretendimin e pestë, si me poshtë:

Sqarojmë ekspertin shqyrtues dhe panelin shqyrtues se neve kemi ofertuar me KËMISHË TAKTIKE

- ME MANGE TE GJATA VERORE komplet sipas kërkesës se AK-se te vendosur ne NJK dhe DT. Pra

AK ka kërkuar qe spaletat te vendosen ne kraheror dhe AK vet ka kërkuar ne DT se :

Faqe 16 nga 42

Pra neve kemi ofertuar me KËMISHË TAKTIKE - ME MANGE TE GJATA VERORE sipas mënyrës se

kërkesës se AK-se pra neve ju pershtatem kërkesës se AK-se ashtu siç kërkojnë ata edhe do ti sjellim

kemishat me spaleta pra komplet sipas kërkesës se AK-se.

6.

pike tjetër e eliminimit sipas AK-së se : Artikulli nr. 4 KËMISHË TAKTIKE - ME MANGE TE GJATA

DIMERORE – sipas mostrës se dorëzuar nga grupi i operatoreve ekonomik vërehet se këmisha dimërore

ne pjesën prapa shpinës është hapur / ka gjarje ndërsa te specifikacionet teknike nuk është kërkuar qe

këmisha te jete e hapur/gjarje prapa shpine pasi qe ne skicën qe është pjese e dosjes se tenderit te Aneksi

1 artikulli nr. 5 duket si me poshtë;

Neve kemi dorëzuar KËMISHË TAKTIKE - ME MANGE TE GJATA DIMERORE komplet sipas kërkesës ase

AK-se te vendosur ne dosje te tenderit për me tepër shih foton me poshtë:

Faqe 17 nga 42

AK ne pergjigjen mbi kërkesën per rishqyrtim dhe ne refuzimin e kërkesës tone na jep kete përgjigje lidhur me

pretendimin e gjashtë, si me poshtë:

Faqe 18 nga 42

Sqarojmë ekspertin shqyrtues dhe panelin shqyrtues se per atikullin KËMISHË TAKTIKE - ME

MANGE TE GJATA DIMERORE neve kemi ofertuar me mostrën komplet sipas kërkesës se AK-se te

vendosur ne NJK dhe DT. Eksperti shqyrtues dhe paneli shqyrtues munden ta shohin mostrën me

sytë e tyre dhe te konstatojnë se mostra jone eshte komplet sipas skices te përcaktuar ne specifika ne

dosje te tenderit se AK-se pra AK ne dosje te tenderit ka prapare se: Duhet të jetë e punuare nga materiali

i fortë poliester/pambuk, rezistente ndaj zbehjes dhe zvogëlimit, e lehte, me ajrosje

Faqe 19 nga 42

7.

pike tjetër e eliminimit sipas AK-së se : Te Aneksi 1 është kërkuar Mbylljet - Duhet të ketë pulla melamine

me 4 vrima tä citat nuk do të shkrihen nga temperatura te larta, nuk digjen, dhe nuk thehen, janë kërkuar

(pulla) 7 ne pjesën e përparme — sipas mostrës se dorëzuar kärnisha ka vetëm 6 pulla;

Neve kemi dorëzuar mostrën e këmishës me shtate pulla me nga katër vrima siç shihet ne foto te me

poshtomë te cilat pulla nuk shkrihen nga temperaturat e larta sipas specifikave teknike te kërkuara ne DT.

Faqe 20 nga 42

Faqe 21 nga 42

AK ne pergjigjen mbi kërkesën per rishqyrtim dhe ne refuzimin e kërkesës tone na jep kete përgjigje lidhur me

pretendimin e shtatë, si me poshtë:

Faqe 22 nga 42

Sqarojmë ekspertin shqyrtues dhe panelin shqyrtues se per atikullin e kemishes Aneksi 1 është

kërkuar Mbylljet - Duhet të ketë pulla melamine me 4 vrima tä citat nuk do të shkrihen nga temperatura

te larta, nuk digjen, dhe nuk thehen, janë kërkuar (pulla) 7 ne pjesën e përparme — sipas mostrës se

Faqe 23 nga 42

dorëzuar kärnisha ka vetëm 6 pullaneve kemi ofertuar me mostrën komplet sipas kërkesës se AKse te vendosur ne NJK dhe DT

Pra ne dosje te tenderit AK ka kërkuar :

Faqe 24 nga 42

Duhet të ketë pulla melamine me 4 vrima të cilat nuk do të shkrihen nga temperatura te larta, nuk digjen, dhe nuk

thehen

Pulla te tipit 20 ligne (12.5mm)

1 ne mes te pjesës së përparme të jakës

7 ne pjesën e përparme

Shihet qarte nga foto se eliminimi i AK-se per kete pike eshte i pa bazuar dhe kjo eshte tendence e tyre

vetëm per te na eliminuar pa kurrfarë baze sepse neve kemi ofertuar me mostra komplet sipas kerkese se

Ak-se ku shume qarte shihen 7 pulla dhe pulla nen jake te cilën e posedon këmisha.

8.

pike tjetër e eliminimit sipas AK-së se : Artikulli nr. 6 KËMISHË TAKTIKE ME MËNGÉ TÉ SHKURTA

Pollo është kërkuar te aneksi 1 • E bërë materiali që nuk ngjitet me Velkro ose me sipërfaqe të tjera

gërryese — sipas mostrës se dorëzuar Velkro ngjitet dhe fijet dalin materiali është i ndjeshëm;

Nuk qëndrojnë këto konstatime te AK-se pasi qe komisioni i ka nxjerr këto konstatime nga shikimet vizuale,

ndërsa neve kemi ofruar atestet e njohura ndërkombëtare me numër nr. 33205 / 10.05.2023 ku e dëshmojnë

cilësinë e këmishës taktike me mëngë te shkurta Polo.

Faqe 25 nga 42

AK ne pergjigjen mbi kërkesën per rishqyrtim dhe ne refuzimin e kërkesës tone na jep kete përgjigje lidhur me

pretendimin e tetë, si me poshtë:

Sqarojmë ekspertin shqyrtues dhe panelin shqyrtues se AK na ka eliminuar per kete pike me konstatimet e tyre te cilat janë sipas hamendjes se tyre ku shume qarte e ka konstatuar sipas atesteve laboratori ndërsa zyrtaret e Ak-se japin konstatime te kudberta me laboratorin sipas shikimit te tyre pra me syt e tyre pra neve kemi shpenzuar shuma te mëdha te parave per këto ateste ku i kemi bashkangjit ato pagesa kurse zyrtaret e AK-se japin konstatime vetëm si ta shohin me sy pse qenka e nevosjme te bëjmë ateste neper laboratorë nderkombetare? Pra AK me tendence na ka eliminuar edhe ne kete pike.

9.

pike tjetër e eliminimit sipas AK-së se : është kërkuar te Aneksi 1 Atestet: • Testi i grisjes — mungon ky

Testimi i grisjes;

Kemi dorëzuar Ateston me numër Nr. 33205/10.05.2023 i UNIVERSITY OF CHEMICAL TECHNOLOGY

AND METALLURGY – SOFIA ku shume qarte përgjigjen na jep tek shembulli numër 1, testi numër 4 – ball

punching strength. Tek ky artikull për materialet e thurura të tekstilit, zbatohet një test i forcës së shpimit

të topit për të vlerësuar forcën. Testi i forcës së grisjes për materialet e thurura të tekstilit nuk zbatohet.

AK ne pergjigjen mbi kërkesën per rishqyrtim dhe ne refuzimin e kërkesës tone na jep kete përgjigje lidhur me

pretendimin e nëntë, si me poshtë:

Faqe 26 nga 42

Sqarojmë ekspertin shqyrtues dhe panelin shqyrtues se nga Laboratori e ka dhene shume qarte se

testi i grisjes dhe metoda se si testohet lidhur me testin e grisjes, ku neve kemi dorëzuar Atestin me

numër Nr. 33205/10.05.2023 i UNIVERSITY OF CHEMICAL TECHNOLOGY AND METALLURGY –

SOFIA ku shume qarte përgjigjen na jep tek shembulli numër 1, testi numër 4 – ball punching strength.

Tek ky artikull për materialet e thurura të tekstilit, por metoda e zbatohet një test i forcës së shpimit të

topit për të vlerësuar forcën.

Ndersa Punetoret e AK-se japin konstatime me te sakta se vet laboratori këtu neve nuk kemi koment.

10.

pike tjetër e eliminimit sipas AK-së se : Artikulli nr 7 KAPELË TAKTIKE është kërkuar te aneksi 1 •

Kapela me 6 pjesë ripstop - sipas mostrës se dorëzuar materiali i kapelës nuk është ripstop ashtu siç

është kërkuar

Neve e kemi dorëzuar mostrën dhe atestet komplet sipas kërkesave te dosjes se tenderit ku një gjë te tille e

dëshmon edhe raporti i testimit me numër nr. 33206/10.05.2023 ku

Faqe 27 nga 42

AK ne pergjigjen mbi kërkesën per rishqyrtim dhe ne refuzimin e kërkesës tone na jep kete përgjigje lidhur me

pretendimin e dhjetë, si me poshtë:

Sqarojmë ekspertin shqyrtues dhe panelin shqyrtues se shume qarte shihet materiali eshte ripstop

ne raportin e testimit me numër nr. 33206/10.05.2023 ku edhe e kemi nënvizuar.

11.

pike tjetër e eliminimit sipas AK-së se : te Aneksi 1 i specifikacioneve teknike; është kërkuar te Aneksi 1

Atestet: • Testi i grisjes — mungon ku Testim i grisjes.

Faqe 28 nga 42

Kemi dorëzuar Ateston me numër Nr. 33206/10.05.2023 i UNIVERSITY OF CHEMICAL TECHNOLOGY

AND METALLURGY – SOFIA ku shume qarte përgjigjen na jep tek shembulli numër 1, testi numër 4 – ball

punching strength. Tek ky artikull për materialet e thurura të tekstilit, zbatohet një test i forcës së shpimit

të topit për të vlerësuar forcën. Testi i forcës së grisjes për materialet e thurura të tekstilit nuk zbatohet.

AK ne pergjigjen mbi kërkesën per rishqyrtim dhe ne refuzimin e kërkesës tone na jep kete përgjigje lidhur me

pretendimin e njëmbëdhjetë, si me poshtë:

Sqarojmë ekspertin shqyrtues dhe panelin shqyrtues se nga Laboratori e ka dhene shume qarte se

testi i grisjes dhe metoda se si testohet lidhur me testin e grisjes, ku neve kemi dorëzuar Atestin me

numër Nr. 33206/10.05.2023 i UNIVERSITY OF CHEMICAL TECHNOLOGY AND METALLURGY –

SOFIA ku shume qarte përgjigjen na jep tek shembulli numër 1, testi numër 4 – ball punching strength.

Tek ky artikull për materialet e thurura të tekstilit, zbatohet një test i forcës së shpimit të topit për të

vlerësuar forcën. Testi i forcës së grisjes për materialet e thurura të tekstilit nuk zbatohet, por metoda e

zbatohet një test i forcës së shpimit të topit për të vlerësuar forcën.

Ndersa Punetoret e AK-se japin konstatime me te sakta se vet laboratori këtu neve nuk kemi koment.

Neve kemi pretendime edhe për Operatorin ekonomik i cili ka aplikuar ne këtë aktivitet te prokurimit pasi qe

AK nuk na ka trajtuar ne mënyrë te barabarte ku gjate qasjes qe e kishim me datën 31.08.2023 kemi vërejtur se

OE tjetër asnjë specifike te kërkuar sipas AK-se nuk e ka plotësuar ne mostra kurse AK nuk ja ka cekur ne

letrën standarde për eliminim.

Faqe 29 nga 42

Tani po i shënojmë një nga një ato te meta qe i kemi vërejtur nga mostrat edhe pse jemi te bindur se ka me

tepër por AK kundërligjshëm nuk na ka dhënë qasje ne atestet e OE tjetër ekonomik.

A.

Ne artikullin numër 1 te Xhaketa taktike është kërkuar:

Xhaketa e jashtme: 100% poliester 2L, elastik mekanik, 176 gr/m2

, me teknologji Durable Water Repellent (DWR)

Xhaketa e brendshme: 100% poliester, 350 gr/m2

, pjesa larte mbrapa 100% najlon

Astari:100%najloni

Xhepat: 100% poliester

Ndërsa OE "Sodex Group" ShPK ka ofruar xhaketë verore dhe dimërore e cila nuk posedon tiketën sipas

kërkesës 176gr/m2 dhe xhaketë brendshme 350gr/m2 e cila ka qene kërkesë e dosjes se tenderit tek

specifikat teknike

Faqe 30 nga 42

Njëjtë edhe tek artikulli numër 2 tek Xhaketa e brendshme mungon gramazha.

Gjithashtu te xhaketa taktike nga AK eshte kerkuar qe pjesa e belit te jete elastike ndersa mostrat e

xhaketave te jashtme OE "Sodex Group" ShPK nuk e permbushin kete kerkese te AK-se pasi qe pjesa

e

belit nuk eshte elastike ndersa AK neve na ka eliminuar per kete pike kurse xhaketa e jone eshte ne pjesen

e belit elastike pra shihet qarte se kunderlisgjeshem na ka eliminuar per kete pike me poshte shih foton e

xhaketes se OE"Sodex Group" ShPK ku shihet qarte se nuk e posedon te pjesa e belit te jete elastike, kurse

AK nuk e ka eliminuar per kete pike.

Ne pergjigjen mbi kërkesën per rishqyrtim dhe ne refuzimin e kërkesës tone lidhur me kete pretendim, AK

na jep kete përgjigje si me poshtë:

Faqe 31 nga 42

Sqarojme ekspertin shqyrtues dhe panelin shqyrtues se shihet qarte se mostra e ofruar OE "Sodex Group"

ShPK ka foertuar si me poshtë:

Ne artikullin numër 1 te Xhaketa taktike është kërkuar:

Xhaketa e jashtme: 100% poliester 2L, elastik mekanik, 176 gr/m2

, me teknologji Durable Water Repellent (DWR)

Xhaketa e brendshme: 100% poliester, 350 gr/m2

, pjesa larte mbrapa 100% najlon

Astari:100%najloni

Faqe 32 nga 42

Xhepat: 100% poliester

Ndërsa OE "Sodex Group" ShPK ka ofruar xhaketë verore dhe dimërore e cila nuk posedon tiketën sipas

kërkesës 176gr/m2 dhe xhaketë brendshme 350gr/m2 e cila ka qene kërkesë e dosjes se tenderit tek

specifikat teknike e kemi ilustruar me foto me sipër.

Njëjtë edhe tek artikulli numër 2 tek Xhaketa e brendshme mungon gramazha.

Gjithashtu te xhaketa taktike nga AK eshte kerkuar qe pjesa e belit te jete elastike ndersa mostrat e

xhaketave te jashtme OE "Sodex Group" ShPK nuk e permbushin kete kerkese te AK-se pasi qe pjesa e

belit nuk eshte elastike ndersa AK neve na ka eliminuar per kete pike kurse xhaketa e jone eshte ne

pjesen

e belit elastike pra shihet qarte se kunderlisgjeshem na ka eliminuar per kete pike dhe shihet qarte se

xhaketa se OE"Sodex Group" ShPK nuk e posedon te pjesa e belit te jete elastike, p[or e ka ne pjesën e

poshtme pra ne fund te xhaketës.

B.

Tek artikulli numër 3 tek pantallonat veror taktik është kërkuar: Te kenë pjesën e gjunjëve te zgjeruar dhe

mundësi hapje nga jashtë për vendosje te mbrojtjes (hapje me velkro).

Tek artikulli numer 3 tek pantallonat veror taktik eshte kerkuar: Te kene pjesën e gjunjeve te zgjeruar dhe

mundèsi hapje nga jashte pèr vendosje te mbrojtjès (hapje me velkro).

OE "Sodex Group" ShPK nuk e posedon mostren sipas kerkeses se AK-se ku ekziston edhe sqarimi

02/05/2023 pergjegja numer 4 nga vet AK, dhe ne specifikim teknik eshte kerkuar hapje ne gjunje Hapje me

Velkro ndersa OE me fjale nuk e ka mostren sipas kerkeses se AK-së, edhe si eshte e mundur qe komsioni i

vleresimit mos te mund ti shoh keto mangesi te OE tjeter ku per ti verejtur keto mangesi nuk duhet kurrfar

profesionalizmi pra edhe dikush qe nuk ka lidhje me keto çështje shum lehte i veren keto mangesi apo

komisioni i vlersimit qellimisht ka mund ti mshef, shih foton si me poshtë:

Faqe 33 nga 42

OE "Sodex Group" ShPK nuk e posedon mostrën sipas kërkesës se AK-se pasi qe ne specifikim teknik është

kërkuar materiali 79-82 polister dhe 18-21 pambuk te pjesa mbrapa gjunjëve 86-88% polister 12-14 spandex

ndërsa OE "Sodex Group" ShPK ka ofruar 65% POLYESTER / 35% COTTON shih foton e mostrës se

pantallonave veror taktik te OE "Sodex Group" ShPK.

Faqe 34 nga 42

Komisioni i vlerësimit te AK-se nuk i ka cekur këto te meta te OE "Sodex Group" ShPK pasi qe siç po shihet

nga vleresimi i tyre "paska qene qene shume vështirë për ti konstatuar për OE "Sodex Group" ShPK"

ndërsa për Neve kane konstatuar gjera te pa qëndrueshme dhe ne kundërshtim me atestet te cilat i kemi

pergaditur per secilën mostër, ky është një diskriminim i hapur i komisionit te vlerësimit ndaj neve si OE ku

shihet qarte se AK është e obliguar me Ligj qe te na trajtoj barabarte te gjithë OE-te qe ofertojmë e jo te na

diskriminoj hapur.

Ne pergjigjen mbi kërkesën per rishqyrtim dhe ne refuzimin e kërkesës tone lidhur me kete pretendim, AK

na jep kete përgjigje si me poshtë:

Faqe 35 nga 42

Faqe 36 nga 42

Sqarojmë eksperin shqyrtues dhe panelin shqyrtues se OE "Sodex Group" ShPK nuk e posedon mostren sipas

kerkeses se AK-se ku ekziston edhe sqarimi 02/05/2023 pergjegja numer 4 nga vet AK, dhe ne specifikim

teknik eshte kerkuar hapje ne gjunje Hapje me Velkro ndersa OE me fjale nuk e ka mostren sipas kerkeses se

AK-së, edhe si eshte e mundur qe komsioni i vleresimit mos te mund ti shoh keto mangesi te OE tjeter ku per

ti verejtur keto mangesi nuk duhet kurrfar profesionalizmi pra edhe dikush qe nuk ka lidhje me keto çështje

shum lehte i veren keto mangesi apo komisioni i vlersimit qellimisht ka mund ti mshef.

OE "Sodex Group" ShPK nuk e posedon mostrën sipas kërkesës se AK-se pasi qe ne specifikim teknik është

kërkuar materiali 79-82 polister dhe 18-21 pambuk te pjesa mbrapa gjunjëve 86-88% polister 12-14 spandex

ndërsa OE "Sodex Group" ShPK ka ofruar 65% POLYESTER / 35% COTTON shih foton e mostrës se

pantallonave veror taktik te OE "Sodex Group" ShPK.

Komisioni i vlerësimit te AK-se nuk i ka cekur këto te meta te OE "Sodex Group" ShPK pasi qe siç po shihet

nga vleresimi i tyre "paska qene qene shume vështirë për ti konstatuar për OE "Sodex Group" ShPK"

ndërsa për Neve kane konstatuar gjera te pa qëndrueshme dhe ne kundërshtim me atestet te cilat i kemi

Faqe 37 nga 42

pergaditur per secilën mostër, ky është një diskriminim i hapur i komisionit te vlerësimit ndaj neve si OE ku

shihet qarte se AK është e obliguar me Ligj qe te na trajtoj barabarte te gjithë OE-te qe ofertojmë e jo te na

diskriminoj hapur.

Pra neve e kemi dëshmuar me prova pranë Ak-se ndërsa AK kudnerligjeshem po e mbron OE "Sodex Group".

AK ne përgjigje ka shënuar se kinse paskemi manipuluar por janë ata vet qe kane manipuluar qe nuk i kane

shënuar te metat e mostrave te OE "Sodex Group".

Neve na kane eliminuar edhe pasi kemi ofruar ateste dhe kundër atesteve vet i kane konstatuar mangesit kurse

po e favorizojnë kete OE duke konstatuar gjera qe nuk qëndrojnë fare, ku ne disa pretendime edhe vet pajtohen

qe OE "Sodex Group" nuk i plotëson kërkesat e AK-se.

C.

Tek Artikulli numër 4 ku neve na kanë eliminuar për ketë pike, ku sipas AK-se, se nuk i kemi pantallonat

Pjesa e belit e vetë përshtatshme (elastike) OE "Sodex Group" ShPK ka dorëzuar mostrat e njëjta sikurse

mostrat tona ndërsa AK na ka diskriminuar ku neve na eliminon për këtë pike ndërsa tek mostrat e OE "Sodex

Group" ShPK te cilat janë te njëjta e plotësojnë kërkesën e AK-se pra edhe mostrat tona e plotësojnë kërkesën

e AK-se por AK nuk na ka trajtuar ne mënyrë te barabarte por shihet se haptas na ka diskriminuar edhe ne

këtë pike. Shih foton e OE "Sodex Group" ShPK me poshtë:

Faqe 38 nga 42

Ne pergjigjen mbi kërkesën per rishqyrtim dhe ne refuzimin e kërkesës tone lidhur me kete pretendim, AK

na jep kete përgjigje si me poshtë:

Sqarojmë eksperin shqyrtues dhe panelin shqyrtues se AK me kurrfarë serioziteti nuk i ka shqyrtuar

pretendimet tona pasi qe neve e kemi patur pretendimin per pantallona kurse këta na pergjigjen per

kemishe.

D.

Tek pantallonat verore dhe dimërore taktike, Testi i qëndrueshmërisë sipas AK-se është kërkuar 40 grade

ndërsa OE "Sodex Group" ShPK ka ofertuar me mostra ku sipas tiketës është 30 grade shih foton me poshtë:

Faqe 39 nga 42

Komisioni i vlerësimit te AK-se "nuk e ka vërejtur" këtë mangësi te OE "Sodex Group" ShPK pasi qe

dyshimet tona janë qe ti përgatitet tereni qe gjate rivlerësimit te ardhshëm AK te ketë me te lehte për ta

rekomanduar për kontrate këtë OE ku qëllimisht janë fshehur te metat e këtij OE edhe pse nuk i ka plotësuar

kërkesat e AK-se sipas dosjes se tenderit, ndërsa neve edhe pse i kemi plotësuar te gjitha kërkesat AK-se, AK

na ka eliminuar kundërligjshëm, një gjë te tille po e faktojmë ne këtë kërkesë për rishqyrtim.

Ne pergjigjen mbi kërkesën per rishqyrtim dhe ne refuzimin e kërkesës tone lidhur me kete pretendim, AK

na jep kete përgjigje si me poshtë:

Vetëm kete pretendim Ak na ka aprovuar qe edhe neve pajtohemi plotësisht.

E.

Tek Artikulli numër 6 është kërkuar që Kapela ; Te ketë te thurur Emblemën e Policisë se Kosovës

Ndërsa OE "Sodex Group" ShPK ka ofruar kapelë ku nga ana e prapme nuk është sipas specifikave te

kërkuara ku ne kapele nuk është kërkuar mbishkrimi "Kosovo Plice" ndërsa OE e ka dorëzuar me këtë

mbishkrim Gjithashtu shihet qarte se edhe materiali nuk është sipas kërkesave te AK-se. shih foton si me

poshtë:

Faqe 40 nga 42

Ne pergjigjen mbi kërkesën per rishqyrtim dhe ne refuzimin e kërkesës tone lidhur me kete pretendim, AK

na jep kete përgjigje si me poshtë:

Faqe 41 nga 42

Sqarojmë eksperin shqyrtues dhe panelin shqyrtues se ne kete pretendim ankimor nuk na janë përgjigjur fare

AK-ja pasi qe i kemi ofruar fakte dhe nuk ka mundur te manipuloj me këto prova.

Neve do te kishim patur edhe me shume pretendime tona ndaj këtij OE por AK ka vepruar

kundërligjshëm

duke mos na dhënë qasje ne Atestet e këtij OE ku dyshojmë se ky OE nuk ka dorëzuar fare ateste.

Një veprim i tille i AK-se bie ndesh me Nenin 10 te LPP-se Mjetet për promovimin e Transparencës.

Siç po shihet me larte AK e ka anuluar kundërligjshëm këtë aktivitet te prokurimit pasi qe neve i kemi

plotësuar te gjitha kërkesat e AK-se te vendosura ne NJK dhe DT pra kemi ofertuar me tender te përgjegjshëm

dhe me Çmimin më te ulët.

Me këtë veprim AK ka bere shkelje te nenit 1 te LPP-së ku thuhet se: vendimet e AK-ve, të mos ndikohen

nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe,

të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji.

Gjithashtu Autoriteti kontraktues nuk ka vepruar ne harmoni me nenin 6 të LPP-së, ku autoritetet

kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në

mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit

ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Gjithashtu shihet qarte se AK ka bere shkelje te nenit 7 te LPP-së ku ne piken 1 thuhet se : Autoriteti

kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në

mënyrë transparente.

Si dhe ne piken 2 thuhet : Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të

prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që

diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik.

Pra neve kemi dorëzuar tender i cili është ne përputhshmëri me te gjitha kërkesat e parashtruara ne

njoftimin për kontrate dhe dosje te tenderit dhe me Çmimin më te ulët

Pra neve kemi dorëzuar tender i cili është ne përputhshmëri me te gjitha kërkesat e parashtruara ne

njoftimin për kontrate dhe dosje te tenderit.

Besojmë se i kemi elaboruar me shume se sa qe duhet shkeljet e AK-se ne këtë aktivitet te Prokurimit

andaj, Kërkojmë nga OSHP qe ta detyroj AK-ne qe ti respektoj ne përpikëri dispozitat ligjore qe janë

Faqe 42 nga 42

ne fuqi lidhur me kete lloj te aktivitetit te prokurimit pasi qe nje kohe e gjate eshte duke u zvarritur ky aktivitet i prokurimit dhe qëllimisht Prokurimi i AK-se po i len pa rroba apo këto uniforma njësinë me elitare te Policise se Kosoves qe janë shume te nevojshme per ta dhe te përfundonje këto manipulime te tyre dhe te çështja te zgjidhet ne favor te Zyrtareve Policor, ne favor te Buxhetit te Policise se Kosoves dhe ne favor te te resopektimit te Ligjit. dhe te nxjerr:

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa e Grupit të Operatorëve Ekonomik: "RUNWAY" SH.P.K ; GENÇ TAAHHÜT GIYIM TEKSTIL INSAAT SANAYI VE TICARET LIMITED SIRKETI lidhur me aktivitetin e prokurimit: Furnizim me uniforma për detyra taktike me nr. te prokurimit: 214-23-2841-1-1-1 dhe Nr. i brendshëm: 214/23/022/111 te iniciuar nga AK- POLICIA E KOSOVËS, dhe II. ANULOHET njoftimi per anulim te kontrates dhe lënda te kthehet ne Rivlerësim dhe pas rivlerësimit te shpallemi fitues i këtij aktiviteti te prokurimit

KRITERET PËR VLERËSIM

c) Operatori Ekonomik duhet të dorëzoj atestet të kryera nga një Laborator i licencuar/Akredituar sipas specifikave teknike te kërkuara	**c) Dorëzimi i atesteve të kryera nga një Laborator i licencuar/Akredituar sipas specifikave teknike te kërkuara**

Artikulli 1

SPECIFIKACIONET TEKNIKE	
	Përshkrimi
1	**Xhaketë Taktike**

Xhaketa dimërore e përberë nga xhaketa e jashtme dhe e brendshme, duhet te kombinon performancën e te gjitha moteve dhe një shumëllojshmëri te përmirësimeve taktike për te siguruar një zgjidhje ideale për veshje për patrullimi dimëror, e mbyllur me shtresa, e papërshkueshme nga era dhe uji, ndërsa ofron një ajrosje shume të mirë.

- **Xhaketa e jashtme**
- 10k/10k e papërshkueshëm nga era dhe uji
- Duhet të ketë xhepa të kraharorit te padukshëm
- Kapela mund të paloset në jakë ose zhvendoset nga xhaketa me zinxhir
- Kapela të ketë mundësi të shtrëngimit me lidhëse elastike
- Duhet te ketë panele për ID ne kraharor dhe ne shpine
- Të ketë dy xhepa me zinxhirë për duar

- Te ketë dy xhepa në kraharor
- Te ketë një xhep brenda
- Te ketë zinxhir origjinal te dyfishte me dy drejtime
- Zinxhiri duhet te mbyllet deri në fund të jakës
- Zinxhiri kryesor duhet të ketë material i cili mbulon tere zinxhirin dhe ky material duhet te mbyllet me butona dhe/ose velkro
- Pjesa e belit duhet te jete elastike
- Mëngët duhet te kenë shtrëngimin me velkro
- Pjesa e mjekrës duhet te jete nga material i bute për komfort dhe mbrojtje nga fërkimet
- Të ketë hapje anësore me zinxhirë për qasje më të lehtë
- Të ketë mbyllje me velkro në dy anët e poshtme te hapjet anësore
- Fundi i xhaketës duhet të ketë lidhëse elastike për shtrëngim me mbajtëse plastike
- Vend për vendosjen e radiolidhjes në dy anët e kraharorit
- **Xhaketa e brendshme**
- Xhaketa e brendshme duhet te lidhet me xhaketën e jashtme me zinxhir
- Xhaketës se brendshme duhet ti hiqen krahët me zinxhir dhe te vishet si jelek
- Të ketë hapje anësore me zinxhirë për qasje më të lehtë
- Të ketë dy xhepa me zinxhirë për duar
- Te ketë dy xhepa në kraharor
- Te ketë një xhep brenda
- Vend për vendosjen e radiolidhjes në dy anët e kraharorit
- Duhet te plotësoj standardin EN343:2019 standard 4-3-X i preferuar.
- Spaletat për bartje te gradave ne kraharor ne krah apo sipas kerkeses edhe ne gjoks
- Te ketë te vendosur Emblemën e PK-se ne krahun e majte (me qepje apo me velkro)
- Te ketë te vendosur Flamurin e Shtetit RKS 6X4 cm ne krahun e djathte (me qepje apo me velkro)
- Te ketë velkro te rrumbullaket 8 cm ne krahun e djathte për vendosjen e emblemave te njësisë
- Për mënyrën e vendosjes se emblemave referoju aneksit
- Mënyra e vendosjes se emblemave dhe spaletave mund te ndryshoj varësisht nga kërkesa
- Ngjyra: E zezë, Teget ose ngjyr tjeter varsisht nga kerkesa
- Madhësitë: S-3XL

Materiali:
Xhaketa e jashtme: 100% poliester 2L, elastik mekanik, 176 gr/m^2, me teknologji Durable Water Repellent (DWR)
Xhaketa e brendshme: 100% poliester, 350 gr/m^2, pjesa larte mbrapa 100% najlon
Astari: 100% najloni
Xhepat: 100% poliester

Funksionaliteti:
Xhaketa dimërore duhet te jete e qëndrueshme, e papërshkueshme nga uji, xhaketë e brendshme me material të butë, dhe të dyja mund të vishen njëkohësisht si një xhaketë. Xhaketa ka në pjesën e jashtme xhepa në kraharor, xhepa dore.

Duhet të ketë pjesën e mjekrës me material të butë për komfort dhe mbrojtje nga fërkimet.

Xhaketa e jashtme është e qepur dhe e ngjitur me tegel plotësisht të vullkanizuar për rezistence ndaj ujit, e qëndrueshme ndaj erës dhe duhet të jete me material që lejon ajrosjen. E tëra e qëndrueshme ndaj ujit, kapela e përshtatshme dhe duhet të ketë mundësinë e palosjes në jakë dhe mundësinë e zhvendosjes tërësisht.

Duhet të ketë panele për ID me mundësi të heqjes në kraharorin e majtë dhe në shpinë.

Sistem me zinxhir të qepur anash për ajrosje të mjaftueshme.

Xhaketa e brendshme është punuar nga materiali i qëndrueshëm ndaj erës, material i butë.

Pjesa e brendshme e xhepave te duarve duhet te jete nga material i bute për komfort dhe ngrohtësi te duarve. Xhaketa duhet ti ketë 10 xhepa. Gjithashtu duhet te ketë dhe vende ku mund te varen gjësende te tjera.

Qepja dhe ngjitja
Komplet materiali i qepur në mënyrë speciale për bllokimin e ujit dhe shiut me qepje me një gjilpërë për ndalje të ajrit dhe ujit. Xhaketa duhet të ketë qepje të forta në pjesët me stres të madh (Bartacks).

Zinxhiri dhe Butonat
Vetëm zinxhirë origjinal YYK ose ekujvalent dhe butona kualitativ PRYM ose ekujvalent ose ekujvalent me kusht qe te jenë me standard te larta dhe te plotsoj standardin europian te cilësis, duhet të përdoren në mënyrë që te zinxhiri të jetë i fortë dhe butonat të rrinë të mbyllura edhe në aktivitete shumë të vështira.

Etiketat

Etiketa me Përmbajtje/Kompaninë, etiketën me numrin e artikullit, etiketa ne vendin ku varet këmisha, dhe etiketa

kryesore te detajuar.

Standardet:

- Testi i rezistencës ndaj depërtimit të ujit
- Testi i rezistencës ndaj avujve të ujit
- Testi i elasticitetit për xhaketën e jashtme
- Testi i grisjes për xhaketën e jashtme
- Testi i fuqisë se qepjes
- Testi i analizës se fibrave për xhaketën e brendshme
- Testi i stabilitetit dimensional ndaj larjes për xhaketën e brendshme
- Testi i larjes për xhaketën e brendshme
- Testi i qëndrueshmërisë se ngjyrës në larje për xhaketën e brendshme
- Testi i elasticitetit për xhaketën e brendshme
- Testi i grisjes për xhaketën e brendshme

Paketimi të jetë i veqant për njësi të produktit që siguron mbrojtje nga dëmtimet dhe elementet tjera gjatë transportit apo ruajtjes.

STANDARDET E LATREPERMENDURA DUHET TE DOKUMENTOHEN ME RAPORTE TESTUESE NGA LABORATORET ME AKREDITIM NDERKOMBETAR.

MOSTRA OBLIGATIVE

Artikulli 2

SPECIFIKACIONET TEKNIKE	
Përshkrimi	
2	**PANTALLONA TAKTIK Verorë**

Pantallona taktik veror duhet të jenë nga materiali poliester elastik mekanik dhe pambuku duhet të jenë të qëndrueshëm, elastik, profesional në dukje, funksional, të kenë jetëgjatësi dhe të sigurojnë qëndrueshmëri të ngjyrës. Pantallona të jenë të njëtrajtshme, efikas, për detyra taktike. Të kenë varg të zgjeruar të opsioneve të lëvizjes dhe ruajtjes. Të kenë xhepa shtesë me madhësi për përdorim taktik.

Përshkrimi



- Përshtatje superiore
- Pjesa e belit e vetë përshtatshme (elastike)
- Të trajtuara me Teflon për rezistente ndaj njollave, ujit dhe baltës
- Rezistente ndaj grisjes ripstop
- Dy xhepa kargo me sistem të integruar të varjes së gjësendeve brenda
- Dy xhepa te mëdhenj anësorë
- Nga dy xhepa brenda xhepave anësorë
- Dy xhepa mbrapa
- Material dy shtresor në gjunjë
- Zinxhirë origjinal YKK dhe butona Prym ose ekujvalent me kusht qe te jenë me standard te larta dhe te plotsoj standardin europian te cilesis
- Lidhëse në fund të pantallonave
- Materiali: Poliester elastik mekanik 79-82% poliester dhe 18-21% pambuk
- Panele elastike mbrapa gjunjëve: 86-88% Poliester 12-14% Spandeks
- Material Ripstop 190-195 gr/m^2.
- Madhësitë: Beli 30-44 numra çift.
- Gjatësia: S-XXL numra çift.
- Ngjyra: E zezë, Teget ose ngjyr tjeter varsisht nga kerkesa.

Materiali

duhet të kenë material elastik të butë në pjesën e belit (anash) tek pjesa e xhepave. Duhet të jene me material elastik i cili mundëson lëvizjen e lehte dhe komfor ne trup.

Pjesa kryesore: Poliester elastik mekanik 79-82% poliester dhe 18-21% pambuk; rezistente ndaj grisjes ripstop; të trajtuara me Teflon për rezistence ndaj njollave, ujit, baltës, yndyrave dhe tharjes me te shpejt nga lagështia. Panele elastike mbrapa gjunjëve: 86-88% Poliester 12-14% Spandeks. Material dy shtresor ne gjunjë.

Qepja dhe përfundimi

Qepja duhet të jetë e fortë me penjë shumë të fortë dhe të jetë e qepur me një tegel të vetëm. Pantallonat duhet të jenë me qepje të fortë në të gjitha pjesët me presion të madh (Bartacks). Te kenë qepje te dyfishta tek pjesa e prapme. Të ketë qepje ne pjesën e poshtme te belit e cila mundëson elasticitetin dhe komoditetin me të mirë ne mes të këmbëve (pjesa e poshtme e belit). Të kenë qepje të zgjeruar të dyfishta tek gjunjët,

Funksionaliteti

Duhet të jenë të punuara nga kombinimi i materialit te fortë Poliester elastik mekanik /pambuk Ripstop, pantallonat duhet të jenë të përshtatshme për kushte të vështira dhe për operacione speciale. Duhet të jenë të qëndrueshme për komfort superior, funksionalitet dhe përshtatje të madhe, pantallonat duhet të kenë shtrëngim në bel të vetë përshtatshme për lehtësim gjatë përkuljes dhe zgjatjes. Pantallonat duhet te kenë material elastik mbrapa gjunjëve për përshtatje superiore gjatë përkuljes / ngritjes, Të kenë pjesën e gjunjëve të zgjeruar dhe mundësi hapje nga jashtë për vendosje te mbrojtëse (hapje me velkro). Te kenë mundësi ngushtimi tek fundi i këmbëve me opsionin me lidhës. Duhet të kenë lidhëse në fund të pantallonave.

Xhepat

Të kenë së paku 3 palë gjepa (xhepa para, xhepa mbrapa dhe xhepa anësor tek këmbët). Te kenë xhepa tek pjesa e belit te hapur pa mbyllje, xhepat e përparmë të pantallonave duhet të jenë të fortë dhe të mëdhenj. Të kenë xhepa te mëdhenj anësorë të lakuar me hapje velkro dhe të kenë ndarje nga brenda. Pantallonat duhet të kenë edhe dy xhepa të pasmë me

hapje me velkro, për mundësin e mbajtjes së gjësendeve për çfarëdo operacioni të punës. Skajet e xhepave të përparmë duhet të jenë të përforcuar me material te forte që të mundësojnë varjen e aksesorëve në xhep dhe qëndrueshmërinë e xhepave.

Duhet të ketë nga dy xhepa të brendshëm brenda xhepave anësore. Xhepat e brendshëm brenda xhepave duhet të jenë të punuar nga materiali i fortë dhe duhet të jenë shumë të thellë. Xhepat e brendshëm duhet të jenë pa mbyllës për përdorim të lehtë dhe duhet të jenë të qepur me qepje të forte dhe të qëndrueshëm. Xhepat anësorë duhet të kenë mbyllëse që palohen dhe të kenë mundësi të mbylljes edhe kur ata janë të mbushur komplet. Xhepat e brendshëm të ndarë duhet të kenë funksion të dyfishtë; gjësendet e vogla duhet të hynë brenda dhe disa aksesorë me kapëse duhet të kenë mundësi të kapen në faqen e xhepave. Palimi i xhepave anësorë duhet të jetë në mënyrë që gjësendet që gjinden brenda të mos dallohen. Xhepat mbrapa duhet të kenë qepje që nuk duken dhe të jenë të qepur me qepje të forte dhe të qëndrueshëm. Xhepat mbrapa te jene të vendosur në pjesën e vitheve poshtë belit. Xhepat mbrapa duhet te jene me mbyllës me velkro.

Xhepat para të jene të hapur ne mënyrë vertikale. Xhepat anësor të jene të vendosur poshtë pjesës ku janë të vendosur xhepat e belit. Paraqitja përmes fotove te përafërta.

Qëndrueshmëria
Pantallonat duhet të jenë te punuara nga materiali poliester elastik mekanik 79-82% dhe 18-21% pambuk ripstop (me bllokues të grisjes) që rezistojnë ndaj grisjes dhe abrazionit. Pantallonat duhet të jenë me qepje të trefishtë në të gjitha vendet me stres të madh.

Zinxhiri dhe Butonat

Të kenë mbyllje me kopse (pulle) te beli dhe mbyllje me zinxhir i cili duhet te jetë i mbuluar me material qe te mos duket. Vetëm zinxhirë origjinal YYK dhe butona kualitativ PRYM ose ekujvalent me kusht qe te jenë me standard te larta dhe te plotsoj standardin europian te cilesis duhet të përdoren në mënyrë që zinxhiri të jetë i fortë dhe butonat të rrinë të mbyllura edhe në aktivitete shumë të vështira.

Standardet:

Atestet:

- Testi i analizës se fibrave
- Testi i stabilitetit dimensional ndaj larjes
- Testi i larjes
- Testi i qëndrueshmërisë se ngjyrës në larje 40°C
- Testi i qëndrueshmërisë se ngjyrës ne uje
- Testi i qëndrueshmërisë se ngjyrës ne drite
- Testi i qëndrueshmërisë se ngjyrës ndaj zbardhjes se klorit
- Testi i elasticitetit
- Testi i grisjes
- Testi i fuqise se qepjes
- Testi qëndrueshmërisë ndaj ujit, shiut
- Testi i rezistencës ndaj tërheqjes (Snagging Test)
- Testi ndaj abrazionit
- Testi i peshes per njesi te sipërfaqes
- Testi i qëndrueshmërisë ndaj flakës

STANDARDET E LATREPERMENDURA DUHET TE DOKUMENTOHEN ME RAPORTE TESTUESE NGA LABORATORET ME AKREDITIM NDERKOMBETAR. MOSTRA OBLIGATIV

Artikulli 3

SPECIFIKACIONET TEKNIKE	
	Përshkrimi
3	**PANTALLONA TAKTIK DIMEROR**

Pantallona taktik dimëror duhet të jenë nga materiali poliester elastik mekanik dhe pambuku duhet të jenë të qëndrueshëm, elastik, profesional në dukje, funksional, të kenë jetëgjatësi dhe të sigurojnë qëndrueshmëri të ngjyrës. Pantallona të jenë të njëtrajtshme, efikas, për detyra taktike. Të kenë varg të zgjeruar të opsioneve të lëvizjes dhe ruajtjes. Të kenë xhepa shtesë me madhësi për përdorim taktik.
Përshkrimi



- **Përshtatje superiore**
- **Pjesa e belit e vetë përshtatshme (elastike)**
- **Të trajtuara me Teflon për rezistente ndaj njollave, ujit dhe baltës**
- **Rezistente ndaj grisjes ripstop**
- **Dymbëdhjetë xhepa**
- **Dy xhepa kargo me sistem të integruar të varjes së gjësendeve brenda**
- **Dy xhepa te mëdhenj anësorë**
- **Nga dy xhepa brenda xhepave anësorë**
- **Dy xhepa mbrapa**
- **Dy xhepa për vendosjen e telefonit,karikatorve apo pajisjeve tjera te nevojshme për operatorin**
- **Zinxhirë origjinal YKK ose ekujvalent dhe butona**

Prym me kusht qe te jenë me standard te larta dhe te plotsoj standardin europian te cilesis.

- **Materiali: Poliester elastik mekanik 64-66% Poliester dhe 34-36% pambuk**
- **Material Ripstop 190-195 gr/m^2.**
- **Madhësitë: Beli 30-44 numra çift.**
- **Gjatësia: S—XXL numra çift.**
- **Ngjyra: E zezë, Teget ose ngjyr tjeter varsisht nga kerkesa.**

Materiali

Duhet të jene me material elastik i cili mundëson lëvizjen e lehte dhe komfor ne trup.

Pjesa kryesore: Poliester elastik mekanik 64-66% dhe 34-36% pambuk; rezistente ndaj grisjes Ripstop; të trajtuara me Teflon për rezistence ndaj njollave, ujit, baltës, yndyrave dhe tharjes me te shpejt nga lagështia. Gjepat: 79-81% Poliester 19-21% Pambuk, te qepura shume fort.
Qepja dhe përfundimi
Qepja duhet të jetë e fortë me 10 shpime për 2.5 cm me penjë shumë të fortë me 5 fije. Qepja duhet të jetë e fortë me penjë shumë të fortë dhe të jetë e qepur me një tegel të vetëm. Pantallonat duhet të jenë me qepje të fortë në të gjitha pjesët me presion të madh (Bartacks).

Funksionaliteti
Duhet të jenë të punuara nga materiali i fortë poliester/pambuk Ripstop, pantallonat duhet të jenë të përshtatshme për kushte të vështira dhe për operacione speciale. Duhet të jenë të qëndrueshme për komfort superior, funksionalitet dhe përshtatje të madhe, pantallonat duhet të kenë shtrëngim në bel të vetë përshtatshme për lehtësim gjatë përkuljes dhe zgjatjes.

Xhepat
Pantallonat duhet te kenë gjithsej 12 xhepa. Xhepat e përparmë të pantallonave duhet të jenë të fortë dhe të mëdhenj. Xhepat te mëdhenj anësorë me mbyllje me velkro. Pantallonat duhet të kenë edhe dy xhepa të pasmë me mbyllje me velkro, për mundësin e mbajtjes së gjësendeve për çfarëdo operacioni të punës. Skajet e xhepave të përparmë duhet të jenë të përforcuar me material te forte që të mundësojnë varjen e aksesorëve në xhep dhe qëndrueshmërinë e xhepave. Xhepa për vendosjen e telefonit afër xhepave te përparmë.

Xhepat e brendshëm brenda xhepave duhet të jenë të punuar nga materiali i fortë dhe duhet të jenë të thellë. Xhepat e brendshëm duhet të jenë pa mbyllës për përdorim të lehtë dhe duhet të jenë të qepur me qepje të dyfishtë për qëndrueshmëri. Xhepat anësorë duhet të kenë mbyllëse që palohen dhe të kenë mundësi të mbylljes edhe kur ata janë të mbushur komplet. Xhepat e brendshëm të ndarë duhet të kenë funksion të dyfishtë; gjësendet e vogla

duhet të hynë brenda dhe disa aksesorë me kapëse duhet të kenë mundësi të kapen në faqen e xhepave. Palimi i xhepave anësorë duhet të jetë në mënyrë që gjësendet që gjinden brenda të mos dallohen. Xhepat mbrapa duhet të kenë qepje që nuk duken dhe të jenë të qepur me qepje të forte dhe të qëndrueshëm. Xhepat mbrapa duhet te jene me mbyllës me velkro.
Xhepat para të jene të hapur ne mënyrë vertikale. Xhepat mbrapa te jene të vendosur në pjesën e vitheve poshtë belit dhe të kenë mundësi mbyllje me velkro. Xhepat anësor të jene të vendosur poshtë pjesës ku janë të vendosur xhepat e belit. Paraqitja përmes fotove te përafërta.

Qëndrueshmëria
Pantallonat duhet të jenë te punuara nga materiali poliester elastik mekanik 64-66% Poliester dhe 34-36% pambuk ripstop (me bllokues të grisjes) që rezistojnë ndaj grisjes dhe abrazionit.

Zinxhiri dhe Butonat
Të kenë mbyllje me kopse (pulle) te beli dhe mbyllje me zinxhir i cili duhet te jetë i mbuluar me material qe te mos duket.
Vetëm zinxhirë origjinal YYK ose ekujvalete dhe butona kualitativ PRYM ose ekujvalent me kusht qe te jenë me standard te larta dhe te plotsoj standardin europian te cilesis. duhet të përdoren në mënyrë që te zinxhiri të jetë i fortë dhe butonat të rrinë të mbyllura edhe në aktivitete shumë të vështira.

MOSTRA OBLIGATIVE

Atestet:

Standardet:

- Testi i stabilitetit dimensional ndaj larjes
- Testi i qëndrueshmërisë se ngjyrës ne uje
- Testi i qëndrueshmërisë se ngjyrës ndaj zbardhjes se klorit
- Testi i qëndrueshmërisë se ngjyrës ne drite
- Testi i rezistencës ndaj tërheqjes.
- Testi i elasticitetit
- Testi i grisjes
- Testi i fuqise se qepjes
- Testi ndaj abrazionit
- Testi i analizës se fibrave
- Testi i peshes per njesi te sipërfaqes
- Testi i qëndrueshmërisë ndaj flakës

STANDARDET E LATREPERMENDURA DUHET TE DOKUMENTOHEN ME RAPORTE TESTUESE NGA LABORATORET ME AKREDITIM NDERKOMBETAR.

MOSTRA OBLIGATIVE

Artikulli 4

SPECIFIKACIONET TEKNIKE	
	Përshkrimi
4	**KËMISHË TAKTIKE – ME MËNGË TË GJATA VERORE**

Këmishë taktike me mëngë të gjata nga materiali poliester elastik mekanik dhe pambuku duhet të jetë e qëndrueshme, elastike, profesionale në dukje, funksionale, të ketë jetëgjatësi dhe të siguroj qëndrueshmëri të ngjyrës. Këmisha të jetë e njëtrajtshme, efikas, për detyra taktike. Të ketë varg të zgjeruar të opsioneve të lëvizjes dhe ruajtjes. Të kenë xhepa shtesë për përdorim taktik.



Përshkrimi

- E përshtatshme, e qëndrueshme dhe funksionale
- Përshtatje superiore
- E trajtuar me Teflon për rezistente ndaj njollave, ujit dhe baltës
- Rezistente ndaj grisjes ripstop
- Jake e përshtatshme e formatit mandarinë
- Shirit me velkro për rregullim te jakës
- Dy xhepa në pjesën e përparme
- Xhep me zinxhir në dy mëngët (tek bicepsi)
- Xhep të dyfishtë për stilolaps në mëngën e majtë
- Mbyllje me zinxhir origjinal YKK ose ekujvalent. me kusht qe te jenë me standard te larta dhe te plotsoj standardin europian te cilesis.
- Materiali: Poliester elastik mekanik 77-80 % Poliester, 20-23% pambuk
- Materiali elastik mekanik 135-140 gr.
- Mëngë të gjata
- Mëngët tek mansheta duhet të kenë shirit me velkro për rregullim
- Spaletat për bartje te gradave ne kraharor
- Te ketë te vendosur Emblemën e PK-se ne krahun e majte (me qepje apo me velkro)
- Te ketë te vendosur Flamurin e Shtetit RKS 6X4 cm ne krahun e djathte (me qepje apo me velkro)

- Te ketë velkro te rrumbullaket 8 cm ne krahun e djathte për vendosjen e emblemave te njësisë
- Për mënyrën e vendosjes se emblemave referoju aneksit
- Mënyra e vendosjes se emblemave dhe spaletave mund te ndryshoj varësisht nga kërkesa
- Ngjyra: E zezë, Teget ose ngjyr tjeter varsisht nga kerkesa.
- Madhësitë: S-3XL

Funksionaliteti

Duhet të jete me material elastik i cili mundëson lëvizjen e lehte dhe komfor ne trup.

Duhet të jetë e punuar nga materiali i fortë poliester/pambuk, rezistente ndaj zbehjes dhe zvogëlimit, e lehte, me ajrosje dhe e trajtuar me Teflon për rezistente ndaj njollave, ujit, baltës, yndyrave dhe tharjes me te shpejt nga lagështia, e gatshme për aksion dhe lëvizje më të shpejta e të lehta.

Këmisha duhet të jetë e përshtatshme dhe e lehte për operacione speciale. Duhet të jetë e qëndrueshme për komfort superior, funksionalitet dhe përshtatje të madhe. Xhepat e kraharorit te këmishës duhet te jene me mbyllje me velkro. Nën xhepat e kraharorit duhet të jene te padukshëm. Këta xhepa duhet të kenë mundësi të mbajnë dokumentet e nevojshme dhe gjithashtu mund te përdoren për mbajtjen e gjësendeve te vogla. Xhep të dyfishtë për stilolaps në mëngën e majtë. Xhep me zinxhir në dy mëngët (tek bicepsi) për dokumentet e nevojshme dhe gjithashtu mund te përdoren për mbajtjen e gjësendeve te vogla. Mbyllje me zinxhir origjinal YKK ose ekujvalent me kusht qe te jenë me standard te larta dhe te plotsoj standardin europian te cilesis. e cila duhet te jete e mbuluar nga material i këmishës për të mos u vërejtur.

Kualiteti

Këmisha duhet të jete nga materiali poliester elastik mekanik 77-80 % dhe 20-23% pambuk. Qepja e këmishës duhet të jetë e fortë me penjë shumë të fortë dhe të jetë e qepur me një tegel të vetëm. Këmisha duhet të jetë me qepje të fortë në të gjitha pjesët me presion te madh (Bartacks).

Secila këmishë të jete e paketuar në qese plastike dhe e palosur me kapës te plastikes.

Mbylljet

Duhet të ketë zinxhir origjinal YKK për mbylljen e këmishës dhe xhepave ose ekujvalent me kusht qe te jenë me standard te larta dhe te plotsoj standardin europian te cilesis.

Zinxhir për mbylljen e këmishës origjinal YKK ose ekujvalent me kusht qe te jenë me standard te larta dhe te plotsoj standardin europian te cilesis.

Zinxhir për mbylljen e xhepave ne dy mëngët tek bicepsi origjinal YKK ose ekujvalent. me kusht qe te jenë me standard te larta dhe te plotsoj standardin europian te cilesis.

Shirit me velkro për rregullim të jakës

Shirit me velkro për rregullim të mëngëve

Etiketat

Etiketa me Përmbajtje/Kompaninë, etiketën me numrin e artikullit, etiketa ne vendin ku varet këmisha, dhe etiketa kryesore te detajuar.

Standardet:

- Testi i stabilitetit dimensional ndaj larjes
- Testi i qëndrueshmërisë se ngjyrës ne uje
- Testi i qëndrueshmërisë se ngjyrës ndaj zbardhjes se klorit
- Testi i qëndrueshmërisë se ngjyrës ne drite
- Testi i rezistencës ndaj tërheqjes.
- Testi i elasticitetit
- Testi i grisjes
- Testi i fuqise se qepjes
- Testi ndaj abrazionit
- Testi i analizës se fibrave
- Testi i peshes per njesi te sipërfaqes
- Testi i qëndrueshmërisë ndaj flakës

STANDARDET E LATREPERMENDURA DUHET TE DOKUMENTOHEN ME RAPORTE TESTUESE NGA LABORATORET ME AKREDITIM NDERKOMBETAR.

MOSTRA OBLIGATIVE

Artikulli 5

5	**KËMISHË TAKTIKE – ME MËNGË TË GJATA DIMRORE**

Këmishë taktike me mëngë të gjata nga materiali poliester elastik mekanik dhe pambuku duhet të jetë e qëndrueshme, elastike, profesionale në dukje, funksionale, të ketë jetëgjatësi dhe të siguroj qëndrueshmëri të ngjyrës. Këmisha të jetë e njëtrajtshme, efikas, për detyra taktike. Të ketë varg të zgjeruar të opsioneve të lëvizjes dhe ruajtjes. Të kenë xhepa shtesë për përdorim taktik.



Përshkrimi

- **E përshtatshme, e qëndrueshme dhe funksionale**
- **Përshtatje superiore**
- **E trajtuar me Teflon për rezistente ndaj njollave, ujit dhe baltës**
- **Rezistente ndaj grisjes ripstop**
- **Të ketë xhepa shtese në pjesën e kraharorit të padukshëm për dokumente**
- **Pulla te fshehur për ta mbyllur jakën**
- **Xhep të dyfishtë për stilolaps në mëngën e majtë**
- **Dy xhepa në pjesën e përparme me hapësirë për stilolaps**
- **Pulla te forta melamine**
- **Materiali: Poliester elastik mekanik 60-62% Poliester dhe 38-40% pambuk**

- **Materiali elastik mekanik 136-140 gr.**
- **Mëngë te gjata**
- **Mëngët të mund te palosen deri mbi bërryl dhe të lidhen me një pullë**
- **Spaletat për bartje te gradave ne kraharor**
- **Te ketë te vendosur Emblemën e PK-se ne krahun e majte (me qepje apo me velkro)**
- **Te ketë te vendosur Flamurin e Shtetit RKS 6X4 cm ne krahun e djathte (me qepje apo me velkro)**
- **Te ketë velkro te rrumbullaket 8 cm ne krahun e djathte për vendosjen e emblemave te njësisë**
- **Për mënyrën e vendosjes se emblemave referoju aneksit**
- **Mënyra e vendosjes se emblemave dhe spaletave mund te ndryshoj varësisht nga kërkesa**
- **Ngjyra:, Teget E zezë ose ngjyr tjeter varsisht nga kerkesa.**
- **Madhësitë: S-3XL**

Funksionaliteti

Duhet të jete me material elastik i cili mundëson lëvizjen e lehte dhe komfor ne trup.

Duhet të jetë e punuare nga materiali i fortë poliester/pambuk, rezistente ndaj zbehjes dhe zvogëlimit, e lehte, me ajrosje dhe e trajtuar me Teflon për rezistente ndaj njollave, njit dhe baltës, e gatshme për aksion dhe lëvizje më të shpejta e të lehta.

Këmisha duhet të jetë e përshtatshme dhe e lehte për operacione speciale. Duhet të jetë e qëndrueshme për komfort superior, funksionalitet dhe përshtatje të madhe. Xhepat e kraharorit te këmishës duhet të jenë të mëdhenj me hapësirë të madhe. Xhepat duhet te kenë mbyllje me velkro. Nën xhepat e kraharorit duhet të kenë xhepat e padukshëm për dokumente. Këta xhepa duhet të kenë mundësi të mbajnë dokumentet e nevojshme dhe gjithashtu mund te përdoren për mbajtjen e gjësendeve te vogla.

Kualiteti

Këmisha duhet të jete nga materiali poliester elastik mekanik 60-62% dhe 38-40% pambuk. Qepja e këmishës duhet te jete nga 10 thurje për 2.5 cm. Pullat duhet të jene origjinale nga melamina dhe duhet te jene shume te forta dhe te durueshme ndaj temperaturave të larta. Pullat duhet te kenë 4 vrima per qepje.

Secila këmishë të jete e paketuar ne qese plastike dhe e palosur me kapës te plastikes, të kenë shiritin për jakë dhe një flutur plastike ne mes të jakës.

Mbylljet

Duhet të ketë pulla melamine me 4 vrima të cilat nuk do të shkrihen nga temperatura te larta, nuk digjen, dhe nuk thehen

Pulla te tipit 20 ligne (12.5mm)

1 ne mes te pjesës së përparme të jakës

7 ne pjesën e përparme

2 pulla funksionale për secilën mëngë kur te palohet

2 pulla për rregullim te secilës mëngë

1 pulle rezervë

Pulla te tipit 14 ligne (8mm)

2 pulla në pjesën e fshehur nën jakë

1 pulle rezervë

Etiketat

Etiketa me Përmbajtje/Kompaninë, etiketën me numrin e artikullit, etiketa ne vendin ku varet këmisha, dhe etiketa kryesore te detajuar.

Atestet:

- Testi i stabilitetit dimensional ndaj larjes
- Testi i qëndrueshmërisë se ngjyrës ne uje
- Testi i qëndrueshmërisë se ngjyrës ndaj zbardhjes se klorit
- Testi i qëndrueshmërisë se ngjyrës ne drite

- Testi i rezistencës ndaj tërheqjes.
- Testi i elasticitetit
- Testi i grisjes
- Testi i fuqise se qepjes
- Testi ndaj abrazionit
- Testi i analizës se fibrave
- Testi i peshes per njesi te sipërfaqes
- Testi i qëndrueshmërisë ndaj flakës

Standardet:

STANDARDET E LATREPERMENDURA DUHET TE DOKUMENTOHEN ME RAPORTE TESTUESE NGA LABORATORET ME AKREDITIM NDERKOMBETAR.

MOSTRA OBLIGATIVE

Artikulli 6

6	KEMISH TAKTIKE ME MËNG TE SHKURTA Pollo

Këmisha taktike polo me mëngë të shkurta duhet te jete e qëndrueshme, profesionale ne dukje, te ketë jetëgjatësi dhe te siguroje qëndrueshmëri te ngjyrës.

Përshkrimi

•Dukje profesionale, ndërtim i qëndrueshëm

•Jake e qëndrueshme ne thyerje, rrudhje

•Xhepa te dyfishtë për lapsa ne mëngën e majtë

•Nga materiali rezistues ne zgjatje, rrudhje dhe zgjerim

•Materiali triko e thurur afërsisht 100% poliester Jersey knit 230-250 g/m² ose ekuivalent

•E bërë materiali që nuk ngjitet me Velkro ose me sipërfaqe të tjera gërryese

•Me tri pulla ne pjesën e përparmë

•Pulla Melamine te cilat nuk digjen, thyhen apo shkrihen

•Xhepat për radiolidhje në secilën shpatull

•Veti anti- kundërmim

•Qepje me tegela ne pjesët kryesore

•Dizajni i përafërt me foton

• Ngjyra: E zezë, Teget ose ngjyr tjeter varsisht nga kerkesa.

•Madhësitë: S-3XL

Qepja dhe përfundimi

madh. Të gjitha qepjet duhet te jenë fleksibile për të parandaluar thyerjet.

Mbylljet

Butona / pulla me 4 vrima te bëra nga Melamina te cilat nuk digjen, thyhen apo shkrihen,

3 Butona / pulla ne qendër te fanellës

Etiketa

Mbishkrimi me Përmbajtje/Kompaninë, mbishkrimi me numrin e artikullit dhe etiketën kryesore te detajuar me kushtet e pastrimit dhe mirëmbajtjen.

Secila këmishe te jete e paketuar ne qese plastike dhe e palosur me kapëse te plastikes.

Atestet:

- Testi i stabilitetit dimensional ndaj larjes
- Testi i qëndrueshmërisë se ngjyrës ne uje
- Testi i qëndrueshmërisë se ngjyrës ndaj zbardhjes se klorit
- Testi i qëndrueshmërisë se ngjyrës ne drite
- Testi i rezistencës ndaj tërheqjes.
- Testi i elasticitetit
- Testi i grisjes
- Testi i fuqise se qepjes
- Testi ndaj abrazionit
- Testi i analizs se fibrave
- Testi i peshes per njesi te siprfaqes

STANDARDET E LATREPERMENDURA DUHET TE DOKUMENTOHEN ME RAPORTE TESTUESE NGA LABORATORET ME AKREDITIM NDERKOMBETAR.

MOSTRA OBLIGATIVE

Artikulli 7 KAPELË TAKTIKE

SPECIFIKACIONET TEKNIKE	
	Përshkrimi
6	**KAPELË TAKTIKE**

Kapela taktike duhet te jete e qëndrueshme, profesionale ne dukje, te ketë jetëgjatësi dhe te siguroje qëndrueshmëri të ngjyrës ndërtuar nga materiali i cili ajroset mirë.

• Kapela me 6 pjesë ripstop

• Materiali i thurur 100% Poliester, rezistente ndaj zbehjes (fade-resistant) i thurur me metodën ripstop me peshë 130-140 gr.

• Rezistente ndaj ujit

• Kapela duhet të jete e punuar nga 6 pjesë, duhet të ketë mbrojtësen e diellit

• Kapela duhet te ketë në secilën pjese nga një vrime që është e qëndisur për ventilim, gjithsej 6 vrima.

• Një madhësi për të gjithë me shirit rregullues për rregullimin e madhësisë

• Dukje profesionale, material i forte

• Material i qëndrueshëm ne thyerje, rrudhje dhe mbajtje te ngjyrës

• Material rezistues ne zgjatje, rrudhje dhe zgjerim

• Modeli i përafërt si Police Baseball cap

• Te ketë te thurur Emblemën e Policisë se Kosovës

• Shkronja te thurura me mbishkrimin POLICE

• Te ketë mundësinë e shtrëngimit për ti ja përshtatur madhësisë se kokës dhe madhësi te ndryshme

• Ngjyra: E zezë, Teget ose ngjyr tjeter varsisht nga kerkesa.

• I qepur me penj te cilësisë se lartë

MOSTRA OBLIGATIVE PËR TA DESHMUAR CILESINE (mostra duhet te përfshij emblemën).

Mostrat për referim te dizajnit do te sigurohen nga Autoriteti Kontraktues varësisht nga kërkesat për porosi.

Atestet:

- Testi i stabilitetit dimensional ndaj larjes
- Testi i qndrueshmris se ngjyrs ne uje
- Testi i qndrueshmris se ngjyrs ndaj zbardhjes se klorit
- Testi i qndrueshmris se ngjyrs ne drite
- Testi i rezistencs ndaj tërheqjes.
- Testi i grisjes
- Testi i fuqise se qepjes
- Testi ndaj abrazionit

STANDARDET E LATREPERMENDURA DUHET TE DOKUMENTOHEN ME RAPORTE TESTUESE NGA LABORATORET ME AKREDITIM NDERKOMBETAR.

MOSTRA OBLIGATIVE **Mostrat obligative .**

kërkuar te Aneksi 1 Atestet: • Testi i grisjes – mungon ky Testimi i grisjes;. Sa i për këtë këtij pretendimi ankimore Grupi i OE ju është i pa saktë pasi që është kërkuar testi i grisjes ndërsa materiali i kësaj këmishe ngjitet në Velkro dhe fijet e materialit janë të ndjeshëm dhe dalin. Pretendimi ankimor është i pa bazuar

Pretendimi 9

Pretendimi ankimor për artikulli nr 6 KËMISHË TAKTIKE ME MËNGË TË SHKURTA Pollo është kërkuar te Aneksi 1 Atestet: • Testi i grisjes – mungon ky Testimi i grisjes;. Sa i për këtë këtij pretendimi ankimore Grupi i OE i është referuar ball punching strength

4.	Ball punching strength	N	BSS 9585	33205	384±3	-	T-21°C 64% RH

Detect language English Albanian Spanish Albanian English Spanish

ball punching strength × forca e goditjes së topit

Sipas OE ankues testi i forcës së grisjes për materialet e thurura të tekstilit nuk zbatohet dhe nga fakt OE ankues pajtohet që nuk e ka testin e grisjesn dhe nga kjo shihet që mungon testi i grisjes. Pretendimi ankimor është i pa bazuar

Pretendimi 10

Pretendimi ankimor për artikulli nr 7 KAPELË TAKTIKE është kërkuar te aneksi 1 • Kapela me 6 pjesë ripstop - sipas mostrës se dorëzuar materiali i kapelës nuk është ripstop ashtu siç është kërkuar te Aneksi 1 i specifikacioneve teknike;. Sa i për këtë këtij pretendimi ankimore Grupi i OE i është referuar test raportit

CERTIFICATE № 141 ЛИ/9.08.2022 VALID TO 29.07.2026

1. **Textile materials of natural, artificial and synthetic fibers and their mixtures, articles of them for** (sample description and identification code)
   household, technical purposes and clothing. Knitted fabrics.
   Textile materials for making **tactical cap – article 7**. Main fabric /ripstop knitted/ black colour, 100%polyester and seam detail (part of a finished product **tactical cap**) for determining seam breaking strength.

Në test raport specifikohet ripstop mirëpo kur të shikohet mostra e dorëzuar e kapelës verehet se materiali i punuar i kapelës nuk është sipas kërkesave të kërkuara në Aneksin 1 te specifikacioneve teknike. Në teste mund të përshkruhet emertimi i materialit mirërpo mostra e dorëzuar nuk e ka materialin ripstop. Pretendimi ankimor është i pa bazuar

Pretendimi 11

Pretendimi ankimor për artikulli nr 7 KAPELË TAKTIKE është kërkuar te aneksi 1 është kërkuar te Aneksi 1 Atestet: • Testi i grisjes – mungon ku Testim i grisjes. Sa i për këtë këtij pretendimi ankimore Grupi i OE i është referuar ball punching strength

4.	Ball punching strength	N	BSS 9585	33205	384±3	-	T-21°C 64% RH

Detect language English Albanian Spanish Albanian English Spanish

ball punching strength × forca e goditjes së topit

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

(VENDIMI MBI RISHQYRTIM)

Përgjigjja ne pretendimet ankimore të Operatori Ekonomik " RUNËAY ; GENÇ TAAHHÜT GİYİM TEKSTİL İNŞAAT SANAYİ VE TİCARET LİMİTED ŞİRKETİ" ,- Prishtinë

Pretendimi 1

Pretendimi ankimor për artikulli nr 1 Xhaketë Taktike Xhaketa e jashtme është kërkuar • 10k/10k e papërshkueshëm nga era dhe uji – mungon në 10k/10k ne testime - sa i për këtë këtij pretendimit ankimore OE ankues i referohet metodave te testeve BSS, EN dhe ISO. Për të vertetuar se këtij Grupi i OE ankuese se testimi i dorëzuar nuk i plotëson specifikat e kërkuara në Aneksin 1 të dosjes së tenderit shih test results si në vijim:

FQ 7.8-1 Test report № 33200/10.05.2023 Page 2 Pages 3

7. TEST RESULTS

№	Parameter	Units	Test methods	ID sample number	Test results	Standard values /requirements/ Method determination limits	Conditions of the test
Sample 1 - main woven fabric black colour for outer tactical jacket							
1.	Quantitative composition	%	BSS EN ISO 1833-1 BSS EN ISO 1833-11	33200	Polyester 100	Polyester 100	-
2.	Mass per unit area	g/m²	BSS EN 12127	33200	176±3	176	T - 21°C 64% RH
3.	Resistance to water penetration	mm of water column	BSS EN ISO 811	33200	1300±10	-	T - 21°C 64% RH

Nga test results qe është e nënvizuar me ngjyrë të kuqe te nr rendor 3. Resistance to ëater penetration. Pikërisht duke u bazuar në këtë testim shihet shumë qartë që nuk është 10k(10,000) mirëpo është ofruar 1.3k (**1300 +- 10**) që do të thotë se nuk e plotëson kërkesën e kërkuar ne specifikacionet teknike prej 10k/10k. Pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Pretendimi 2

Pretendimi ankimor për artikulli nr 1 Xhaketë Taktike Xhaketa e jashtme është kërkuar • **Pjesa e belit duhet te jete elastike** – sipas mostrës nuk është elastike. Sa i për këtë këtij pretendimi ankimore OE

ankues nuk ka ditur të bëj dallimin në mes të belit dhe shpinës pasi që OE ankues ka bërë foto mostrës e vet në pjesën e shpinës dhe nuk ka bërë foto në pjesën e belit ashtu siç kërkohet në Aneksin të specifikacioneve teknike. Kërkesa e AK ne specifikacionit teknike është Pjesa e belit duhet të jetë elastike ndersa siaps mostrës së dorëzuar nga OE ankues është jo eleastike shih foto

Nga fotoja e me sipërme shihet se pjesa e belit **nuk është elastike** ashtu siç është e kërkuar ne dosjen e tenderit Aneksi 1 i specifikacioneve teknike.

Për të vertetuar se si duhet të jetë pjesa elastike ne Xhaketë në pjesen e belit shih fotot

Po të krahasohen fotot e sipërme shihet dallimi në mes të mostrës të ofruar nga Grupi i OE ankues

dhe me këtë shihet se nuk i plotëson specifikacionin teknike të kërkuar në Aneksin 1. Pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Pretendimi 3

Pretendimi ankimor për artikulli nr 1 Xhaketë Taktike Xhaketa e jashtme është kërkuar është kërkuar te Aneksi 1 Standardet: • Testi i analizës se fibrave për xhaketën e brendshme – mungon ku Testim (STANDARDET E LATREPERMENDURA DUHET TE DOKUMENTOHEN ME RAPORTE TESTUESE NGA LABORATORET ME AKREDITIM NDERKOMBETAR); Sa i për këtë këtij pretendimi ankimore OE ankues i referohet testi me numër 1 quantitative composition nëse përkthehet në shqip është si në vijim:

Nga shihet që nuk shkruan Testi i analizëz së fibrave po ka të bejë me përbërjen sasiore. Pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Pretendimi 4

Pretendimi ankimor për artikulli nr 3 Pantallona Taktik Dimeror është kërkuar • Pjesa e belit e vetë përshtatshme (elastike) - sipas mostrës pjesa e belit nuk është elastike; Sa i për këtë këtij pretendimi ankimore.

Pretendimi 5

Pretendimi ankimor për artikulli nr 4 KËMISHË TAKTIKE – ME MËNGË TË GJATA VERORE është kërkuar te Aneksi 1 • Spaletat për bartje te gradave ne kraharor – sipas mostrës mungon vendi për vendosjen e spaletave për bartje te gradave ne kraharor; Sa i për këtë këtij pretendimi ankimore Grupi i OE ju është referuar pikës "Mënyra e vendosjes se emblemave dhe spaletave mund te ndryshoj varësisht nga kërkesa" ky i ka ikur pikës ku kërkohët decidivishtë • *"Spaletat për bartje te gradave ne kraharor"* ndërsa mostra e ofruar nuk i ka spaleten për bartjen e gradave ne kraharor për më tepër shih foton e këmishës ku verehet se nuk janë spaletat për vendosje të gradave në kraharor



Grupi i OE me qellim nuk ju është referuar pikës me të cilin përkon me kërkesën e kërkuar në Aneksin 1 te dosjes se tenderit kjo veret edhe në foto pasi që ka foton e mostrës që është dorëzuar mostra në diten e hapjes dhe foto tjeter nuk dihet se ku është bërë fotoja qe dallojn njëra me tjetren. Pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Pretendimi 6

Pretendimi ankimor për artikulli nr 5 KËMISHË TAKTIKE–ME MËNGË TË GJATA DIMRORE – sipas mostrës se dorëzuar nga grupi i operatoreve ekonomik vërehet se këmisha dimërore në pjesën prapa shpinës është hapur/ ka gjarje ndërsa te specifikacionet teknike nuk është kërkuar qe këmisha te jete e hapur/gjarje prapa shpine pasi qe ne skicën qe është pjese e dosjes se tenderit te Aneksi 1 artikulli nr 5 duket si me poshtë;



Sa i për këtë këtij pretendimi ankimore Grupi i OE ka tentuar të bejë divijime duke i ikur mostrës së dorëzuara pasi që ka bërë foto duket e paluar pjesët e hapura në mënyrë qe të mos duken dhe këtë e ka bashkangjitur në kërkesën për rishqyrtim. AK ka bërë foto mostrën e dorëzuar për artikullin me nr 5 KËMISHË TAKTIKE–ME MËNGË TË GJATA DIMRORE ku shihet se në pjesën e pasma në shpinë është e hapur/ka gjarje që më së miri mund të verehet sipas mostrës që është dorëzuar si në vijim

Nga mostra e më sipërme shihet qe mostra nuk është e qepur po ka pjese që janë të hapura/gjarje.
Pretendimi ankimor është i pa bazuar

Pretendimi 7

Pretendimi ankimor për artikulli nr 5 KËMISHË TAKTIKE–ME MËNGË TË GJATA DIMRORE – Te Aneksi 1 është kërkuar Mbylljet - Duhet të ketë pulla melamine me 4 vrima të cilat nuk do të shkrihen nga temperatura te larta, nuk digjen, dhe nuk thehen, janë kërkuar (pulla) 7 ne pjesën e përparme – sipas mostrës se dorëzuar këmisha ka vetëm 6 pulla;

Është kërkuar

Mbylljet

Duhet të ketë pulla melamine me 4 vrima të cilat nuk do të shkrihen nga temperatura te larta, nuk digjen, dhe nuk thehen

Pulla te tipit 20 ligne (12.5mm)

1 ne mes te pjesës së përparme të jakës

7 ne pjesën e përparme

Sa i për këtë këtij pretendimi ankimore Grupi i OE ka tentuar të bëjë devijime duke i ikur numrit të saktë të pullave duke bërë shtrembërimin të kërkesave të kërkuara dhe mostrës së dorëzuare pasi që ka bërë foto e këmishës duke bëre numrin e të gjitha pullave duke përfshire edhe pullën ne mes te pjesës se përparme të jakës.

Kërkesa e AK është si në vijim:

Mbylljet - Duhet të ketë pulla melamine me 4 vrima të cilat nuk do të shkrihen nga temperatura te larta, nuk digjen, dhe nuk thehen

Pulla te tipit 20 ligne (12.5mm)

1 ne mes te pjesës së përparme të jakës

7 ne pjesën e përparme

Mostra e dorëzuar nga Grupi i OE është si në vijim



Ndërsa mostra e OE " RUNWAY " përmban pullat 1 + 6 shih foton ndërsa është kërkuar 1+7

Ndërsa mostra e OE tjetër " SODEX Group" përmban pullat 1 + 7 shih foton

Duke ju referuar foton e me sipërme mostra e OE " RUNWAY" vërehet se janë gjithsejtë 7 pulla mirëpo sipas kërkesës ne Aneksin 1 janë kërkuar 1 pulle ne mes te pjesëve së përparme të jakës ku bashkohen dy pjesët e jakës si dhe janë kërkuar 7 pulla ne pjesën e përparme nga fotoja shihet se mostra e këmishës janë gjithsejtë 7 pulla duke përfshirë edhe pullën ne mes te dy jakave ndërsa pjesa e përparme i ka 6 pulla. Edhe në këtë rast ky Grup i OE ka tentuar të bëjë shtrembërimin e fakteve të kërkuara në dosjen e tenderit dhe mostrave te dorëzuara nga ana e tij. Pretendimi ankimor është i pa bazuar

Pretendimi 8

Pretendimi ankimor për artikulli nr 6 KËMISHË TAKTIKE ME MËNGË TË SHKURTA Pollo është

Sipas OE ankues testi i forcës së grisjes për materialet e thurura të tekstilit nuk zbatohet dhe nga fakt OE ankues pajtohet që nuk e ka testin e grisjesn dhe nga kjo shihet që mungon testi i grisjes. Pretendimi ankimor është i pa bazuar

Pretendime ankimore ne lidhje me OE tjeter pjesëmarrës në këtë aktivitet te prokurimit.OE ankues në ofertën e dorëzuar ka plotësuar Aneksi 3 kërkesë për konfidencialitet të dosjes se tenderit qe Atestet laboratorike janë konfindenciale. Në lidhje me këtë juve ju është bërë e diturë se atestet janë konfindenciale për palë të treta.

Pretendimi A

Etiketat
Etiketa me Përmbajtje/Kompaninë, etiketën me numrin e artikullit, etiketa ne vendin ku varet këmisha, dhe etiketa kryesore te detajuar.

Pretendimi ankimor se ne etiketa nuk shkruan gramazha e xhaketes se jashtme dhe te brendshme një kerkes e tilla nuk është e specifikuar detajisht se qka duhet të përfshije etiketa me cilat të dhenat duhet ti përmbaje. Etiketa përmbaj përmbajtjen e materialit, numrin e xhaketes, etikata kryesore e detajuar me të dhënat e prodhuesit. Pretendimi ankimor është i pa bazuar

Sa i përketë xhaketes sipas Grupit te OE që pretendon qe OE " Sodex Group" në mostren e dorëzuar nuk përmbush kërkesat e AK qe " pjesa e belit nuk është elastike". Ky pretendim ankimore është sqaruar ne pretendimin me nr 2 ku OE " Sodex Gruop" ka dorëzuar mostren sipas kerkësave te AK ku pjesa e *belit është elastike* për me tëper refuroju fotos me poshtë;



Ky pretendim i juaji është i pa bazuar ne fakte pasi qe sipas fotos se lartë shihet që pjesa e belit eshte elastike ashtu siç është kërkuar ne dosjen e tenderit. Pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Pretendimi B

Artikulli 2: PANTALLONA TAKTIK Verorë , është kërkuar Të kenë pjesën e gjunjëve të zgjeruar dhe mundësi hapje nga jashtë për vendosje te mbrojtëse (hapje me velkro).

Në lidhje me këtë ju njoftojm se panatollat veror taktik ne Aneksin 1 te dosjes së tenderit është artikull me numer rendor 2 sic është shënuar më sipër e jo si ju pretendoni me nr rendor 3. Pretendimi ankimor se mostra duhet "*Të kenë pjesën e gjunjëve të zgjeruar dhe mundësi hapje nga jashtë për vendosje te mbrojtëse (hapje me velkro)*" është i pa qendrushem pasi që OE ankues me qellim ka vendosur ne kerkesen për rishqyrtim foton e Artikullit nr 3 Pantollona dimerore pasi që në këtë artikull me nr 3 nuk është kërkuar që të kenë pjesen e gjunjëve te zgjeruar dhe mundësi hapjes nga jashte për vendosjen te mbrojtese (hapja me vlekro). Për të vertetuar pretendimin e OE ankues se ky pretendim është i pa bazuar kjo mund te vertetohet sipas mostrave që janë bërë mostres së dorëzuar nga OE. Foto si ne vijim

Nga fotoja e më sipërme verehet se artikulli me nr 2 pantollona taktik veror i plotësojne specifikat teknike të kerkuara në dosjen e tenderit. Pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Sa i përketë artikulli me nr 2 pantollona taktik veror sipas Grupit te OE që pretendon qe OE " Sodex Group" nuk posedon mostren sipas kërkesë se AK pasi qe ne specifika teknike është kërkuar materila 79-82 polister dhe 18-21 pambuk te pjesa mbrapa gjunjëve 86-88% polister 12-14 spandex ndërsa OE "Sodex Group" ShPK ka ofruar 65% POLYESTER / 35% COTTON shih foton e mostrës të

pantallonave veror taktik tË OE "Sodex Group" ShPK.
OE ankues për qellime të veta ka manipoluar me fotografi duke ju referuar tiketës së artikullit nr 3 pantallona dimëror. Ky manipulim i OE është i pa qendrueshem pasi që OE " Sodex Group" i ploteson specifikacionin teknike te kërkuar ne dosjen e tenderit për me tepër shih foton

Nga fotoja e sipërme verehet se pretendimi i OE ankues është i pa qendrueshem pasi që OE " Sodex Group " ka dorëzuar specifikat teknike 80% polister me 20 pambuk ndërsa të pjesa mbrapa gjunjëve 87% polister 13% spandex që është brenda limiteve të përcaktuara në specifikacionet teknike. Edhe ne kete pretendim OE ankues ka manipuluar me fotografi ne mes te artikujve. Në asnje menyrë AK nuk ka bërë diskrimin në mës të ofertuesve mirërpo OE ankues ka bërë manipulime në mes fotove të artikujve 2 dhe 3. Pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Pretendimi C

Artikulli 4: KËMISHË TAKTIKE – ME MËNGË TË GJATA VERORE, në këtë artikull nuk është kërkuar që pjesa e belit e vetë përshtatshme (elastike).
Në lidhje më këtë pretendim ankimor OE ankues ju eshte referuar artikullit me nr 4 këmishë taktike me mengë të gjata verore ku askund në specifikacionet teknike nuk është kërkuar që pjesa e belit e vetë përshtatshme (elastike). Si do që të jetë prap pjesa e belit vete pershtatshme elastike tek arikulli nr 3 pantallona dimëror shihet qe e ka pjesën elastike te vete përshtatshme. Pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Pretendimi D

Pretendimi ankimor se te Artikulli 2: PANTALLONA TAKTIK Verorë dhe dimëror është kërkuar • Testi i qëndrueshmërisë se ngjyrës në larje 40°C ndërsa **Artikulli 3: PANTALLONA TAKTIK dimëror** ne specifikacionete teknike te detyrueshëm Aneksi 1 është kërkuar
• Testi i qëndrueshmërisë se ngjyrës në larje 40°C.

Sa për dijeninë e juaj ju njoftojmë se për artikullin nr 2 pantallona veror dhe **Artikulli 3: PANTALLONA TAKTIK dimëror** është kërkuar • Testi i qëndrueshmërisë se ngjyrës në larje 40°C . OE ne ketë specifikacion ka dështuar dhe është i pa përgjegjshëm pasi qe te dy artikujve me

tiketat te vendosura ne pantallona qe dëshmojnë larjen e ne temperaturë te lejuar 30°C dhe **Ky pretendim ankimore është i bazuar.**

Pretendimi E

Pretendimi ankimor se artikulli 7: KAPELË TAKTIK është kërkuar • Te ketë te thurur Emblemën e Policisë se Kosovës.

Tek Artikulli numër 6 është kërkuar që Kapela ; Te ketë te thurur Emblemën e Policisë se Kosovës Ndërsa OE "Sodex Group" ShPK ka ofruar kapelë ku nga ana e prapme nuk është sipas specifikave te kërkuara ku ne kapele nuk është kërkuar mbishkrimi "Kosovo Plice" ndërsa OE e ka dorëzuar me këtë mbishkrim edhe ne pjesën e prapme te kapelës shih foton per ilustrim te prezantuar ne FDT aneksi 1.

Foto ilustrim (DT)

Foto e kapelës mostër te OE afruar "Sodex Group" ShPK"

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund te parashtroj ankese pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohen brenda dhjetë (10) ditëve pas këtij vendimi.
Vendimi i publikohet: Në platformën elektronike në adresën https://e-prokurimi.rks-gov.net

Vendimi i dërgohet:
- *OE ankues*
- *Të gjithë OE tjerë pjesëmarrës në këtë aktivitet,*
- *Zyrës se Prokurimit,*
- *ZKA-së,*

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **RUNWAY SH.P.K.**

Pretendimi nr.1

Pretendimi I pare ankimore sipas ankesës 715/23 ka të bëjë me arsyene e liminimit të OE, ku sipas AK-së I njëjti nuk ka plotësuar kërkesën për 10K/10K, pasi sipas rezultatit te atestit del se xhaketa/materiali qëndrueshmërinë/rezistencën ndaj ujit e ka 1300mm e jo 10000 (10K) siç është kërkuar.

Sqarim : shkornja "K" nga gjuha latine "Kilo" do thotë "mijë", dhe qdo numër që pason me shkronjën "K" nënkupton atë numër plus tri zero (mijë) pas ati numri.

Në rastin konkret numri 10K duhet lexuar 10000 (dhjetëmijë).

Fillimisht sqarojmë se kërkesa e e AK-së 10K/10K nënkupton rezitencën ndaj derpertimit të ujit dhe aftësinë e frymëmarrjes së materialit, ku numri I parë 10K nënkupton 10000, dhe paraqet rezistencën e materialit ndaj depertimit të ujit në milimetra te kolonës së ujit. Kjo nënkupton se materiali duhet ti qëndroj presionit prej 10 000 mm kolonë të ujit para se uji të filloj të depërtoj.

Ndërsa numri I dytë 10K paraqet aftësinë e materialit për liruar avullin, dhe numri 10000 nënkupton peshën në Gram të ujit në formë të avullit , e cila duhet të kaloj në një metër katror te bëzit/materialit për 24 orë.

OE ka ofruar atest ku rezultati I qëndrueshmërisë/rezistencës së ujit është 1300 mm.

Provë: Oferta e OE ankues – Raporti testimit nr.33200/10.05.2023

OE ankues pretendon në ankesë se testi dëshmon se është ofruar rezistencë 1300K (që nënkupton 1300000), mirëpo kjo nuk qëndron.

Në atestin e ofruar shumë qartë shihet se njësia matëse është "milimietra kolone uji", dhe rezultati është 1300+-10 (+-10 nënkupton devijimin/tolerancën e testit).

Për më tepër, pas hulumtimeve të shumta që kemi bërë nuk kemi gjetur se ka material te rrobave me rezitencë 1300K (1300.000), pasi kjo do nënkuptonte rezistencë te materialit nën presionin e 1300 metrave kolonës së ujit.

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendinmi ankimjorë është I pabazuar.

Pretendimi nr.2

Arsyeja tjetër e limiimit është se mostra për xhaketë e OE ankues nuk e ka belin elastik.

OE në ankesë parqet foton e mostrës, dhe e nënvizon pjesën elastike , mirëpo sipas nesh kjo është pjesa e epërme e shpinës/ më mes dy krahëve dhe nuk është pjesa e belit.

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendinmi ankimjorë është I pabazuar.

Pretendimi nr.3

Arsyeja e eliminimit me radhë ka qenë se OE nuk ka ofruar testim për analizë të fibrave.

Pas analizimti të ofertës së OE ankues, kemi gjertur se për xhaketë të jashtme dhe të brendshme ka ofruar teste ku figoron se materiali është 100% polyester.

Provë: Oferta e OE ankues – Raporti testimit 33200/10.05.2023

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është I bazuar.

Pretendimi nr.4

Aryseja e eliminimit se pantollonat nuk e kanë pjesën e belit elastike.

OE pretendon se plotëson kërkesën e AK-së.

OE ofron fotografi të mostrës , mirëpo të njëjtën shihet se pjesa elastike është më poshtë, në nivel me gjepat e pantollonave, andaj konsiderojmë se nuk është në pajtim me kërkesat e dosjes.

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është I pabazuar.

Provë : Ankesa e OE ankues – Fotografia e mostrës.

Pretendimi nr.5

Arsyeja e eliminimi është se OE nuk ka pjesën Velcro për vendosjen spaletave në Krahëror.

OE pretendon se e plotëson kërkesën dhe në ankesë ofron foto të mostrës, mirëpo nga e njëjta foto shihet se Velcro për vendosjen e spaletave është pjesën e gjyksit, jo të kraharorit.

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është I pabazuar.

Pretendimi nr.6

Arsyeja e eliminimit është se mostra e këmishës ka hapje në pjesën e epërme të shpinës, e cila nuk është parashikuar me dosje të tenderit.

OE pretendon se mostra është në pajtim me kërkesa të dosjes, megjithëkëtë pas analizimit të dosjes dhe specifikave vlerësojmë se një gjë t tillë nuk ka qenë kërkese, dhe mostra nuk është në pajtim me kërkesa të dosjes.

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është I pabazuar.

Pretendimi nr.7

Arsyeja e elinminimit tëo E ankues është se janë kërkuar 7 pulla për këmishën, ndërsa OE ankues ka ofruar mostrën me 6 pulla.

Sqarojmë se kërkesa decidive në dosje ka qenë kështu:

"Pulla te tipit 20 ligne (12.5mm)

1 ne mes te pjesës së përparme të jakës

7 ne pjesën e përparme

2 pulla funksionale për secilën mëngë kur te palohet

2 pulla për rregullim te secilës mëngë

1 pulle rezervë

Pulla te tipit 14 ligne (8mm)

2 pulla në pjesën e fshehur nën jakë

1 pulle rezervë"

Nga fotot e mostrës të prezantuar nga OE ankues shihet këmisha ka 7 pulla duke përfshirë pullën e përparme të jakës.

Në rastin konkret konsiderojmë se kërkesa e AK-së ka qenë sadopak konfuze, andaj bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është pjesërisht i bazuar dhe vlerësojmë se kjo mund të konsiderohet devijim I vogël në pajtim me dispozitat ligjore nw fuqi.

Pretendimi nr.8

Arsyeja e eliminimit është se këmisha taktike me mëngë të shkurta është "*E bërë materiali që nuk ngjitet me Velkro ose me sipërfaqe të tjera gërryese — sipas mostrës se dorëzuar Velkro ngjitet dhe fijet dalin materiali është i ndjeshëm".*

Në rastin konkret nuk mund të japim përgjigje pasi nuk kemi kapacitet Teknik / professional për të bërë një testim të tillë, se a kapet materiali për "Velcro".

Pretendimi nr.9

Arsyetimi i eilimiimit se mungon testimi grisjes.

Pas analizimti të ofertës së OE ankues kemi gjetur atestet ku është dhënë rezultati për girsjen.

Provë : Atestet e ofruara nga OE

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është I bazuar.

Prtendimi nr.10

Arsyeja e elinimit është se OE ka ofruar mostrën e kapelës e cila nuk është nga materiali "Rip stop".

OE pretendon se mostra është në pajtim me kërkesë dhe I referrohet atesteit për kapelën.

Pas analizimit të atestit për kapelën, bvlerësojmë se në atest fjala "rip stop" është e shënuar te përshkrimi I mostrës që testohet, I cili përshkrim jepet nga vet klienti që e dërgon mostrën për testim.

Ndërsa në rezultat e testimit nuk figuron se materiali është rip stop.

Për më tepër në cilësi të ekspertit shqyrtuers, ne kemi qenë në vizitë pranë AK-Policia e Kosovës dhe kemi shikuar dhe analizuar mostrat, dhe vlerësojmë se mostra e kapelës së OE ankues nuk është nga materiali Rip Stop.

Sqarim shtesë: materialet rip stop janë materiale të cilat e kanë një qepje shtesë e cila e rritë rezistencën ndaj grisjes, zakonisht në formë katërkëndëshi ose gjashtëkëndëshi, dhe një qepje e tillë

mungon mostrën e OE ankues.

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është I pabazuar.

Pretendimi nr.11

Arsyetimi tjetër për eliminim është se mungon atest/testimi I grisjes për kapenëlën.

Pas analizimit të ofertës së OE ankues kemi gjetur se OE ka ofruar atest për kapelen ku gjendet edhe testimi I grisesjes.

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendinmi ankimjorë është I bazuar.

Pretendimi nr.12

OE ankues pretendon se OE tjetër pjesëmarrës nuk ka ofruar xhaketën me tiketë ku shënon pesha e materialit. Po ashtu pretendon se pantallonat nuk e kanë përbërjen/materialin e kërkuar, se nuk kanë qëndrueshmërinë e larjes në temperaturë 40 gradë celsiusë siq është kërkuar.

Pas analizimit të ofertës së OE tjetër pjesëmarrës kemi gjetgur se I njëjti atestet I ka të deklaruara si informata konfidenciale, andaj të dhënat nga këto ateste nuk kemi drejtë ti bëjmë publike në këtë raport.

Megjithatë japim përgjigje se për të gjitha këto kërkesa (që pretendon OE ankues) OE tjetër ofertues ka ofruar ateste në pajtim me kërkesat e dosjes duke përfshirë edhe temperaturën 40 gradë cilcius.

Ndërsa sa I përket mostrave , pas vizitës që kemi bërë pranë AK-së dhe shikimit dhe analizimit të mostrave, vlerësojmë se të njëjtat janë në pajtim me kërkesat e dosjes së tenderit, përjashtimisht mostrës së kapelës e cila në pjesën e prapme e ka të shënuar "Kosovo Polcie", gjë që nuk është kërkuar me specifikacion teknik.

Megjithëkëtë konsiderojmë se kjo përbën devijim të vogël, pasi mostra nuk ka mangësi nga ajo qka është kërkuar, mirëpo OE ka "shtuar" fjalët "Kosovo Police" me qëllim të identifikimit nga prapa. Kjo konsiderojmë se në rast të eventual të nënshkrimit të kontratë do ishte lehtësisht e evitueshme gjatë realizimit të kontratës.

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është pjesërisht i bazuar.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesësht e bazuar, ndërsa të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **POLICIA E KOSOVËS**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **RUNWAY SH.P.K.**

REPUBLIKA E KOSOVËS ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI PRISHTINË/A REPUBLIKA KOSOVA

Ilir Halili